



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.02.2015** me fillim në ora **10.00**. Të pranishëm: delegatët e KK-së, kryetari dhe nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE, Kfor-Lmt, monitorues të KDI, mediat e të tjerë. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**, i cili në fillim ka përshëndetur të pranishmit dhe për këtë mbledhje ka propozuar këtë:

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2014,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit komunal për efikasitet të energjisë – PKEE 2015-2020,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar janar-dhjetor 2014,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2014 në vitin 2015,
6. Formimin e komisionit për ndryshim dhe plotësim të statutit të komunës
7. Shqyrtimi i kërkesës së Bashkësisë Islame në Rahovec lidhur me Vendimin 01 NR. 242 të datës 30.01.2015,
8. Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për subvencionim,
9. Ndryshimi i anëtarëve në Komitete
10. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi – Nëse pajtoheni që pikën e 5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për organizimin e brendshëm të administratës të Komunës së Rahovecit të hiqet nga rendi i ditës për shkak se organizimi i brendshëm që është bërë tek zyra e Kryetarit është në kundërshtim me statutin e komunës, e në vend të kësaj të futet **Formimin e komisionit për ndryshim dhe plotësim të statutit të komunës** për shkak se kanë pësuar ndryshime edhe dy komitete, Komiteti për Politik dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete janë zvogëluar në numër, a pajtoheni që të zëvendësohet me këtë pikë, e qes në votim, kush është për: Me 4 abstenime dhe të tjerët pro është aprovuar. Po ashtu propozojë si pikë të fundit kam menduar që ta qesim rreth disa ndryshime që duhet ti bëjmë sa i përket komisionit për bursa, Komitetit për shërbime publike si dhe komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Po ashtu edhe Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duhet të caktohet një përfaqësues nga AAK-ja. Kush është për këtë propozim? me 2 abstenime dhe tjerët pro është aprovuar edhe jo pikë. Kemi edhe një kërkesë nga Drejtori i Shërbimeve Publike sa i përket pikës së 6 nëse pajtoheni që ta qesim si pikë të 3 të rendit të ditës, meqenëse përfaqësuesit e organizatës nuk kanë kohë të rrinë ma tepër dhe është interes i yni që të kemi informacione shtesë edhe nga ata, e qesë në votim kush është për këtë propozim? Me 2 abstenime dhe tjerët pro aprovohet. E qesë në aprovim rendin e ditës me këto ndryshime dhe plotësime kush është për? Konstatohet se rendi i ditës është aprovuar në mënyrë unanime.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar, procesverbalin e keni pas edhe në formën elektronike dhe sipas informatave që i kam askush nuk ka bërë vërejtje dhe nëse ka dikush tani urdhëroni.

Erlira Mullabazi – Përshëndetje propozimi im në mbledhjen e kaluar ka qenë që nga ulja e taksave për 10% të përjashtohen bankat, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, KEDS it t'i ritet taksat nga 1.000 € në 2.000 €, ndërsa këtu nuk figuron miratimi i këtyre propozimeve.

Kryesuesi – E qesë në aprovim procesverbalin kush është për? Konstatohet që në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë.

2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2014, raporti përfshinë secilën drejtori.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të shkojë në pika të shkurta sa i përket raportit ndërsa për detaje do ju japin drejtorët e drejtorive. Më lejoni t'ju falënderoj për bashkëpunimin që e kemi pasur për vitin 2014 i cili vit ka qenë mjaftë sfidues, ku të gjithë e dimë se si komunë kemi punuar me buxhet të vitit 2014 me shumë kontrata të lidhura me projekte të ndryshme të cilat ne i kemi vazhduar të gjitha ato punë që kanë qenë të nisura nga qeverisjet e kaluara, dhe përkundër obligimeve të mëdha buxhetore që i kemi pasur ndaj operatorëve të ndryshëm. Unë do isha fokusuar në obligime që i kemi pasur ndaj operatorët në vitet e kaluara dhe do ju njoftojë për projektet e reja të cilat kanë filluar gjatë vitit 2014. Paga dhe mëditje buxheti i planifikuar për 2014 ka qenë 6,237,444.01 € dhe është shfrytëzuar 6,228,062.99 €. Në Investime kapitale buxheti i planifikuar ka qenë 3,388,363.29 € dhe është shfrytëzuar në shumën prej 3,268,936.60 €. Në mallra dhe shërbime të planifikuara kanë qenë 638,637.21 €, janë shfrytëzuar në shumë prej 634,577.04 €, në Komunalitë 226,203.60 € ndërsa janë shfrytëzuar 226,174.45 €, në subvencione kanë qenë të planifikuara 106.128 € janë shpenzuar 105,950.50 €. Totali i planifikuar ka qenë 10,596,776.11 € dhe janë shfrytëzuar 10,463,701.58 €, siç e dini ka pasur një shkurtim nga niveli qendror në mallra dhe shërbime në vlerë 140.000 €, pastaj obligimet në fund të vitit 2013 kemi trashëguar në shumën e mjeteve financiare në investime kapitale 2,64,236.99 €, në mallra dhe shërbime 74,250.03 €. Pra këto kanë qenë obligime që komuna është dashur ti paguaj borxhet deri në fund të vitit 2013, në komunalitë 30,159.94 € totali është 2,168,646.96 €. Më lejoni t'ju informojë se tani në këtë muaj që jemi na ka ardhur një kërkesë të një borxhi të gazetës Info Pres të cilët pretendojnë se komuna ju ka borxh 20.000 €, ata na kanë prurë një faturë të borxhit që nga viti 2008 dhe ne jemi në verifikim të asaj, po ashtu edhe gazeta Zëri pretendon se i kemi borxh rreth 4.000 € po ashtu borxh i viteve të mëhershëm, këto nuk janë të futura në pjesën që unë raportova pak më parë. Çka është paguar fatura të vjetra prej vitit 2010 deri në fund të vitit 2013 dhe faturat që kanë ekzistuar prej 2010 deri në 2013 që nuk janë paguar dhe që ne i kemi paguar në 2014, janë paguar 1,700.000 € në investime kapitale, borxhin e vitit 2010 e kemi paguar 31,417.41 centë, për vitin 2011 është paguar borxhi prej 214,624.51€, për borxhi i vitit 2012 e kemi paguar 634,180.75 €, dhe për borxhin e vitit 2013 është paguar 1,184,014.32 € pra këto janë shënime zyrtare të

drejtorisë së financave, në mallra dhe shërbime kemi trashëguar një borxh prej 74,250.03 € janë paguar 55.000 €, të vitit 2011 janë paguar 3,434.88 €, të vitit 2012 janë paguar borxhet 6,734.84 €, të vitit 2013 janë paguar borxhet 64,080.55 € kryesisht këto janë të shënuara si borxh për naftë, vetura, drega zyrtare, mëditje dhe telefona mobilë, komunalit janë paguar 30,159.94 € borxh të trashëguara, të hyrat vetanake të planifikuara kanë qenë 950.000 € ndërsa janë realizuar 1,17,539.62 €, investimet nga donatorët projektet me bashkëfinancim, pritet të fillojë ndërtimi i shkollës në Rahovec, shoqata e vreshtarëve shtëpia e verës projekt nga bashkimi evropianë, rregullimi i obollëve të shkollave në Xërxë dhe Rahovec është përfunduar nga UN HABITAT, ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Xërxë faza parë është punuar pritet që sivjet të vazhdojë faza e dytë, nxehe qendrore në shkollën fillore në Ratkovc MZHE, gypi shtytës paralel i ujësjellësit rruga e UÇK-së Rahovec në bashkëpunim me KRU Radoniqin, mbështetja e sektorit të bujqësisë është unioni evropian zyra në Kosovë 5.000 €, pastrimi i lumit 4.500 € instituti rinvest për hulumtime zhvillimore, operativa e grave të Krushës 46.000 € BE, të gjitha projektet që kanë të bëjnë me infrastrukturën që kanë qenë të filluara në vitin 2013 dhe kanë të bëjnë me infrastrukturën komunale nëpër gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit janë duke vazhduar edhe këtë vit por ka të atillë që do të vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm ndoshta edhe në vitin 2017 siç është rasti me projektet e kullimit të tokave në pjesën perëndimore të komunës dhe në fshatin Celin. Ka filluar ndërtimi i rrugës Pastasel – Kaznik, është shtruar rruga Bratotin – Drenovc, është punuar në një projekt për zgjerim të sistemit të ujitjes në fshatin Sopniq.

Selim Duraku - Raporti vjetor është mirë i përmbledhur për secilën drejtori, është bërë një punë e mirë duke pasur parasysh se komuna ka qenë e keq menaxhuar më parë me borxhe të mëdha. Tek Drejtoria e bujqësisë sa e pashtë ndërrimi destinacioneve toka bujqësore në toka ndërtimore janë dhënë diku afër 31 pëlqime. Kisha propozuar që të ndalet kjo dhe ti jepen sa ma pak pëlqime sepse secilën herë janë duke na u pakësuar tokat bujqësore.

Përparim Krasniqi – Raporti i Kryetarit ka vetëm një faqe e gjysmë sa po shoh ndërsa pjesët tjera janë të sektorëve të drejtorive. Raporti ka disa mangësi nuk është i precizuar mirë nuk ka qëllime nuk ka sfida të caktuara dhe nuk është i ndarë sipas sektorëve që duhet të ndahet një raport i cili duhet të raportohet, tek raporti te zyra e kryetarit thotë sfida furnizimi me ujë të pijshëm, e që mendoj se kjo duhet të ndahet dhe të ceket tek sfidat, qëllimet dhe të arriturat e kryetarit për qeverisjen 1 vjeçare, përmendet edhe vlera e borxheve të pa paguara. Unë e kisha pyetur kryetarin se gjatë vitit 2014 sa donacione ka thithur kryetari i komunës, debat me qytetarë sa e di unë i ka mbajtur vetëm 2 dhe ato në fund të vitit është mbajtur një debat ad- hoc ku pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë e pakët. Vetë fakti që keni deklaruar se aktivitetet e mija janë të shumta në teren ndërsa në raportin vjetor shihen vetëm 5 aktivitete, Xërxë, Fortesë, Pastasel, Koznik, dhe në qytetin e Rahovecit, ndërsa aktivitetet e tjera nuk janë të shkruara që mendoj se është gabim. Tek Drejtoria e Shërbimeve Publike shumica e punimeve janë të periudhës 2012-2013, e shoh këtu që ndërtimi i rrugës Apterushë-Rreti është duke vazhduar edhe në vitin 2014 dhe kjo nuk është e vërtetë, sepse asnjë punim nuk ka vazhduar në vitin 2014 dhe është në gjendje shumë të keqe. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim mendojë që ka po ashtu ngecje sepse drejtori nuk e ka cekur se kur e ka marrë detyrën, dhe sa pe shoh unë ky raport është i njëjti si kur kam qenë unë drejtor në 2013 vetëm sa ju ka ndërruar shifrat dhe viti sepse asgjë të re nuk ka. Drejtoria e financave ku thotë se me respektimin e vendimeve administrative me shkurttime buxhetore prej 15 %, sa po shoh në 3 pika që i ka cekur asnjë pikë nuk është respektuar. Tek Drejtoria e Arsimit ka vërejtje të mëdha ku thuhet se janë bërë ndryshime të mëdha por aty nuk ka pasur ndryshime por ka pasur ngecje dhe shkelje të shumta sepse aty ka disa borxhe të pa paguara disa dënime që i janë bërë Drejtorisë së arsimit.

Luljeta Kadiri – E përgëzojë drejtorin e shëndetësisë për bashkëpunimin, dëshirën dhe vullnetin për punësimin e të kualifikuarve me marrëveshjen me CARITAS Kosovën dhe besoj se do të jetë një marrëveshje e re për 2015. Kam një pyetje tek kujdesi shtëpiak, a do të funksionoj si duhet sepse në 2014 është zbeh kjo dhe popullata ka nevojë për kujdesin shtëpiak. Tek dhënia e certifikatave për patentë shofer më parë ka pasur mjaft të ardhura nga kjo dhe pse është ndërprerë tash dhe qytetarët tanë shkojnë në Prizren, Gjakovë dhe Prishtinë. Po ashtu tha drejtori që kemi pas të hyrat më të mëdha gjatë funksionimit të aparatit të rëntgenit ndërsa që një vit e gjysmë nuk është duke punuar aparati dhe dua ta di arsyen e mosfunksionimit dhe si janë distribuar punëtorët e kabinetit të rëntgenit në këtë periudhë një vit e gjysmë. Kam bërë edhe një pyetje në kompensimin e punëtorëve të kujdestarisë konform Udhëzimit administrativë, drejtori dha disa sqarime dhe ato mbesin që të shqyrtohen në 2015. Tek sfidat më vije mirë se çdo punë ka përparësi dhe ka sfida dhe drejtori i ka cekë këtu sfidat dhe mendojë që është pak e vështirë që të tejkalohen sepse shumë herë hasim në rezistenca, por unë mendoj që sfida e parë që do ta ketë drejtori është funksionalizimi i mjekësisë familjare dhe me implementimin e statutit të ri do ta ketë edhe ma lehtë drejtori.

Mirjeta Krasniqi – Unë e shfletova raportin ishte një përmbledhje e mirë, por unë kam një pyetje për drejtorin e administratës së përgjithshme, tek sektori i gjendjes civile – kërkesat, martesat vendore shifra 465, nuk besoj se duhet të jetë në Euro pasi që martesat vendore kushtojnë 10 € dhe duhet të jetë 4650€, tek martesat e jashtme nëse është 92 numri i martesave duhet llogaritur në 50 € që kushton një martesë dhe del shifra 4600 € dhe në fund të hyrat totale duhet të ndryshojnë me shifër të re.

Ejup Kabashi – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, Raporti i kryetarit të komunës është shumë modest dhe ai nuk i ka përshkruar të gjitha aktivitetet sa i përket 2 vizitave në Apterushë që i ka pasur por kjo është modestia e tij. Unë e kam lexuar raportin në detaje dhe të gjitha raportet nga drejtoritë vinë me sfidat që i kanë kaluar. Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike se çfarë fati ka ujësjellësi në Reti, kur do të aktivizohet uji se punimet gati janë në përfundim, sa i përket rrugës Apterushë-Reti besoj se në këtë vit do të përfundojë.

Rukije Krasniqi – Raporti i Kryetarit nuk përshkruan qartë dhe saktë gjendjen aktuale, nuk tregon për vonesat e qeverisë së tij. Në Raport nuk flitet aspak për rezultatet, por vetëm tentohet të përvehtësohen rezultatet dhe sukseset e qeverisë së kaluar. Raporti është kundërthënës dhe në shpërputhje me realitetin. Kur është në pyetje sukse si qeverisë së kaluar në njërin anë, e përvehtësojnë dhe krenohen e në anën tjetër injorojnë kategorikisht tërë atë punë që është kryer. P.sh. ndërtimi i shkollave dhe i QMF-ve, kur nuk flitet për ngecjet funksionale të QMF-ve dhe AMF-ve në komunën tonë. Gjithashtu kryetari nuk ka përshkruar qartë ato premtimet që i ka bërë në zgjedhjet lokale dhe i ka premtuar rinisë së do të ketë subvencione rreth 150.000 €, por unë shohë këtu vetëm 35.000 € ku shihet qartë se KB dhe KF janë në gjendje të mjerueshme, sportistët nuk po kanë veshmbathje sportive, gjithashtu mungon palestra sportive dhe kur mungon palestra mungojnë edhe stërvitjet dhe rezultatet nuk janë premtuese. Në faqen 17 kemi një tabelar dhe nuk

po shihet se çka shkruan aty, kjo ndoshta bëhet që ti hutojnë këshilltarët e Kuvendit komunal. Tek tabelari të hyrat nga qiraja, shoh se disa biznese të favorshme të juaja nuk kanë paguar asnjë cent për vitin e kaluar dhe kanë arritur borxhet dikush 17.000 € dikush 60.000 € dhe kështu me radhë, dhe ju premtoni se do të ketë të hyra nga qiraja por siç po shihet nuk ka për të ndodhur por po më duket se po pritët që të ritet borxhi dhe të i falet 50 % i borxhit. Në faqe 48 tek menaxhimi i mbeturinave - sektori i mjedisit, nëse dalim nga qyteti duke shkruar për në Prishtinë dhe në anën tjetër Apterushë, shohim që mbeturinat e kanë mbuluar tërë rrugën dhe në fshatrat tjerë më të mëdha si në Krushë dhe Ratkovc, është një ndotje e madhe kryesisht nga mjetet e ngurta, po ashtu aty ka edhe mbjellje të fidanëve që është mirë për gjelbërimin dhe në një pikë përgatitje të projektit me paramasa dhe parallogaritë si një shpallje të tenderit për krijimin e hapësirave të gjelbëruara në Rahovec. Pra, këto mbeturina le të lirojnë dyokside të karbonit sepse i duhet bimëve për foto sintezë. Shërbime telefonike 869€ vetëm për drejtorë, a është për një vit apo për një muaj. Po ashtu edhe për Rahovecin e bujqësisë dhe Rahovecin evropianë, por më duket se nuk do të jemi as në Azi. Tek Drejtoria e arsimit numri i madh i mungesave tek nxënësit prej 2786 sish kanë 16.891 mungesa, pra i bie 61 mungesë për një kokë të nxënësit për një vit, ky është jashtëzakonisht numër i madh i mungesave, por shihet se shkollat fillore qëndrojnë më mirë. Po ashtu kam një pyetje për kryetarin, tash disa mësimdhënës që kanë zëvendësuar nëpër disa shkolla tjera në pushimet e lehonisë ato kanë qenë në marrëdhënie pune, por atyre u është afuar vetëm që të bëjnë zëvendësime edhe pse kanë qenë me përvojë, por ata janë zëvendësuar me punëtorët e reja. Vetëm në shkollën Isa Boletini janë 5 punëtorë të reja, kur të kthehen nga lehonja dhe kthehen mësimdhënës në punë çdo të ndodh me ato mësimdhënës që i keni premtuar vende pune.

Besnik Hoti – Raportin e kam lexuar dhe kam hasur në projektet të cilat kanë filluar në vitin 2013, mua më intereson a ka projekte të reja përveç atyre që kanë filluar ma herët, nëse po cilat janë ato dhe deri ku kanë arritur punimet. Po ashtu disa projekte që janë këtu në raport posaçërisht në Drejtorinë e shërbimeve publike ku thotë se ndërtimi i trotuareve në fshatrat Dabidol, Gexhe Ratkovc dhe Çifllak, në fshatin Ratkovc asnjë trotuar nuk është punuar. Po ashtu kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë, ambulanca në fshatin Polluzhë është e ndërtuar por nuk funksionon, cila është arsyeja.

Kadri Dellova – Unë e kam lexuar në detaje Raportin e kryetarit po vetëm ata që janë shkurt pamës nuk dëshirojnë që të pranojnë realitetin, sepse për mu është një raport shumë voluminoz. Kryetari ka paraqitë një raport detal të shtruar në shumë segmente të qeverisjes komunale, duke filluar prej kryetarit si ekzekutiv e deri tek performanca shumë e suksesshme e gjithë drejtorëve. Do të ndalem tek Drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe turizëm, unë shoh vazhdimisht edhe në vitet paraprake edhe tash disa kompani të mëdha i kanë mbetur borxh komunës, i di disa raste që organet komunale i kanë bërë presion disa bizneseve të vogla që ti paguajnë borxhet, ndërsa kompanitë e mëdha figurojnë me borxhe enorme. Ne të gjithë e dimë se qeverisja komunale figuron në bazë të hyrave vetanake dhe falë këtyre të hyrave komuna jonë ka fituar grande nga qeveria. Pyetja është se a keni ndërtuar ndonjë strategji që këto kompani që i shfrytëzojnë objektet e komunës t'i paguajnë borxhet.

Bahtjar Hoti – Unë nuk e di se ku janë duke i gjetur gjithë këto fjalë dhe lëvdata që janë duke i dhënë Kryetarit, po të shkosh ti pyesësh qytetarët e fshatit Babovc në çfarë mjerimi janë duke jetuar dhe se si vuajnë ata që të shkojnë deri në shkollë fëmijët e tyre, ndërsa nëpër disa fshatra dhe në qytet kemi shtrirjen e trotuareve dhe komoditet të tepëruar, ndërsa fshatarët e fshatit Babovc vuajnë për të shkruar deri tek mjeku, dhe nuk pashë askund në raport që është në plan rregullimi i rrugës në fshatin Babovc, nuk ka rëndësi që ai fshat ka pak vota, por edhe ata janë qytetarë dhe tatimpagues të kësaj komune.

Sinan Bajraktari – E përgëzojë kryetarin për raportin e bërë. Kam një pyetje rreth projektit të kanalizimit të fshatrave Polluzhë dhe Pastasel. Është e vërtetë se puna në fshatin Polluzhë është kryer rreth 80 % sa kemi pasur mundësi edhe në fshatarët e kemi inspektuar punën dhe besoj se puna është bërë në nivel, por vijat të cilat kanë kaluar nëpër disa rrugë të lagjeve e kanë prishur rrugën në një masë mjaftë të madhe, pra unë dua ta di se operatori i cili i ka kryer punimet a ka pas për detyrë që rrugët ti kthejë në gjendjen e mëparshme.

Lirih Berisha – Unë desha të ndalem dhe ti tregojë disa gjëra që janë punuar dhe që mund të shihen sepse asnjë qeveri nuk mundet t'i kryej punët për 4 vite e as për 40 vite. Unë dua ta falënderojë qeverinë komunale për rrugën e ndërtuar Drenovc-Bratotin dhe firma e cila i ka kryer, i ka kryer me një kualitet mjaftë të mirë sepse këtyre dy fshatrave për 50 % ju është shkurtuar rruga që të vijin në Rahovec, po ashtu edhe një falënderim për rrugët që janë kryer në rrugët lokale brenda në fshat. Kam edhe një kërkesë për këtë vit që të investohet në fshatin Pastasel dhe Sanovc sepse këto fshatra kanë mbetur pa investime.

Fatmir Iska – Meqenëse Kryetari nuk dëshiron të lavdërohet atëherë ne do e kritikojmë mbase ka vend për kritika. Shkojmë nga faqja 3 tek raporti vjetor, kryetari thotë është dashur të merremi me çështje tjera siç janë rritja e disiplinës dhe respektimi i orarit të punës dhe kjo është diçka jo e vërtetë. Në vitin 2011 ka qenë një gjendje kaotike sa i përket disiplinës dhe respektimit të orarit të punës, prandaj e kemi vendosur aparatit e skenimit në mënyrë që të evidentohen hyrjet dhe daljet të punëtorëve dhe kishim një gjendje ma të mirë se tani. Po ashtu këtu përmenden takime të shumta por nuk ka veprime konkrete. Në faqen 4 thotë përmirësimi i infrastrukturës rrugore, sidomos nëpër fshatra dhe lagje të qytetit, por kjo nuk qëndron në aspektin e asaj të propagimit të borxheve të mëdha komunale dhe pikërisht këto borxhe janë për përmirësimin e kësaj infrastrukture në fshatra dhe qytet. Në faqe 6 sektori për administratë të përgjithshme në kuadër të Drejtorisë për administratë, ku thotë se është formuar komisioni prej 5 anëtarësh për verifikim e dosjeve të punëtorëve të punësuar nga dhjetori 2010 deri në janar 2014. Cili ka qenë rezultati meqenëse ne nuk kemi qenë të informuar dhe pjesë e atij komisioni kanë qenë pikërisht njerëz të punësuar gjatë kësaj periudhe. Tek Drejtoria për kulturë, rini dhe sport janë shënuar disa subvencione, por është interesante se janë shënuar disa vlera shumë të vogla për disa manifestime, si p.sh. akademi përkujtimore për Tonin dhe Micin, shpenzimi 15.00€, manifestimi i përvjetorit të USAID shpenzim 20.00 €, festimi i ditës ndërkombëtare të fëmijëve 1 qershori shpenzim 50.00 €, në faqe numër 11 ekspozitat dhe punimet e artit pamorë kolonia e artistëve 3.973 €, po ashtu kemi edhe subvencionimin pikërisht për këtë Art Studios kemi 2.000 €. Pra, shpenzime vetëm për këtë shoqatë për aktivitetin që e ka zhvilluar për vitin 2014 janë diku 6.000 €, dhe nëse marrim për bazë vetëm klubi KF Rahoveci për krejt periudhën që luan 14.550 €.

Pasqyra e pagesave të asistencës sociale për vitin 2014 mu që më ka ra në sy është diferenca ndërmjet muajit tetor, ku kemi familje që janë me asistencë sociale 753 dhe në nëntor në 667 përfutues të asistencës sociale, pra 86 familje janë jashtë kësaj skeme. Pyes se

aq shumë qenka zbutur varfëria tek këto familje për një muaj. Te Drejtoria për shëndetësi tek kilometrazhet dhe shpenzimi i derivateve, në 2013 kemi 121.841 km të kaluara ndërsa derivate të shpenzuara 15,807.87 L që është paradoks me periudhën krahasuese të vitit 2014 janar - Nëntor ku kemi 124937 km dhe derivate kemi 15,322.35 L, pra, dallimi është se në 2014 kemi më tepër 3.100 km të kaluara ndërsa 500 L më pak të shpenzuara. Tek faja numër 23 po ashtu te kjo drejtori, po e citoj paragrafin e fundit tek participimi Nro kabinet që kemi pasur në vitin 2013 me vlerë prej 970 € ndërsa në vitin 2014 nuk jam duke e parë për shkak se tabela është e gjitha e zezë dhe nga kjo kohë nuk punon Rëntgeni dhe kemi një diferencë prej 870 € ndërsa po të ishte funksional Rëntgeni atëherë do të kishim ngritje të hyrave. Ju kisha lutë që të rregulloni Rëntgenin. Në faqen numër 37 tek Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim janë cekur detyrat dhe aktivitetet që janë përfunduar. Këtë e kam cekë edhe në KPF që kjo ma tepër i ngjason një SWAT analizë se sa një raport i punës vjetore. Tek Drejtoria për financa dhe buxhet në faqen 58 ku thotë buxheti jo i aprovuar për vitin 2014 dhe shkurtimi 15 % në mallra dhe komunal. Buxheti që nuk është aprovuar shkaktar ka qenë partia e kryetarit, po ashtu ceken disa shkurtime të shpenzimeve administrative që mund të shihen edhe në raportin financiarë si edhe obligimet që janë nga viti 2010 deri me 2013 në vlerë për 2013 në 1,184,000 € dhe kur të mbledhen të gjithë arrin diku vlera dy milionë e disa mijë euro që janë prezantuar, por duhet të ceken edhe disa obligime që kanë qenë më herët në qeverisjen e PDK dhe njëra me tjetrën aspak nuk ka korresponduar nëse e marrim suficitin komunal që ka ndodhur dhe ne kemi borxhe të mëdha dhe në të njëjtën kohë ka ndodhur suficiti. Pra, kjo nuk është as ironi po as cinizëm i nderuari kryetar, dhe pikërisht ai mos votimi i buxhetit nga ana e Kuvendit hiq më pak se 634.000 € i kanë munguar. Tek Drejtoria e arsimit shqetësuese është numri i mungesave të nxënësve, po ashtu ka pas arritje edhe të rezultateve pozitive nga ana e Drejtorisë si projekte të mira që janë bërë, është rregullimi i oborreve të shkollave, fillimi i punëve për shkolla të reja, po ashtu kemi edhe shkollën e re që po ndërtohet tek Isa Boletini, është donacion i fituar nga komisioni evropian dhe assesi nuk është projekt i fituar nga kryetari aktual por nga qeveria e kaluar.

Rasim Fazliu - Unë e përgëzoj kryetarin për këtë raport që na ka afruar dhe në mënyrë të detajuar janë të përfshirë të gjitha aktivitetet që kanë qenë në vitin 2014. Është kryer një punë e mirë, por megjithatë unë nuk jam i kënaqur me gjithë atë që është kryer, sepse duke u bazuar në atë se çka ka trashëguar kjo qeveri e tanishme nga qeveria e kaluar një shumë aq të madhe të burgjeve unë çuditë se si kanë mundur ta sjellin gjendjen ashtu si duhet dhe ta stabilizojnë. Këta zotërinjtë këtu e dinë se mos miratimi i buxhetit është pikërisht për shkak mos transparencës së tyre dhe futjes në borxhe të mëdha, pra, faji nuk është i kuvendarëve por është i ekzekutivit të kaluar. Konsideroj se raporti i kryetarit është i qartë, ka transparencë të plotë ku mund të shihen të gjitha të dhënat. Inkurajues është fakti se kemi edhe tejkalim të të hyrave vetanake. Dallim tjetër i kësaj qeverie nga qeveria e kaluar është se kjo qeveri ka arritur të bëjë kursime tek kategoria mallra dhe shërbime. Unë do isha ndalur tek disa çështje në raport. Kolegu foli për shpenzimin e derivateve 2013-2014, unë ju them se në vitin 2013 shpenzimi mesatar ka qenë 13 L në 100 km, ndërsa në vitin 2014 shpenzimi mesatar për 100 km ka qenë 12.26 L dhe unë dyshoj se këta ndoshta vetëm me të dytën e kanë vozitur makinën. Tek Drejtoria e shërbimeve publike ne e dimë se sa mjete kanë qenë të paraparë për tërë komunën e Rahovecit, të shpenzohen për kubëzim të rrugëve, po vetëm në Krushë të Madhe i kanë shpenzuar 210,538.49 €, punimet janë realizuar kurse nuk i është paguar asnjë qindarkë punë kryesit, dhe borxhi ka mbetur që kjo qeveri e tanishme ta paguaj ndërsa tani këta zotëri thonë se kanë të drejtë morale të flasin. Po ashtu kam edhe disa pyetje që do i parashtojë. Lumi "Dullo", më intereson sa investime gjatë qeverive së kaluar ka pasur deri më sot në këtë projekt dhe edhe sa duhet që të kryhet. Po ashtu edhe rruga në Krushë të Madhe që qon tek Drini sa ka kushtuar ai projekt, poligoni sportiv që na është premtuar në fshatin Celinë dua ta di pse la ngecje. Si sukses të kësaj qeverie ju informoj se Komuna e Rahovecit e ka një partneritet të lidhur me Qendrën grumbulluese të pemëve dhe perimeve në Xërxë qendër që me të vërtet ka korrur suksese edhe për shkak të përkrahjes të Komunës. Unë do i ceki disa të dhëna që kanë shkruar drejtpërdrejtë në favor të qytetarëve të komunës së Rahovecit, janë 486 fermerë që janë përfitues të vlerës prej 130,763.00 €, këtu futen ambalazhime, trajnime, makina bujqësore, spërkatje etj. Dhe në fund kisha kërkuar që të gjitha projektet që janë në vazhdim të kryhen si i ka hije një komune dhe mos të përsërisim gabimet e qeverisjes së kaluar.

Beatrisa Demiri – Po ashtu edhe unë mendoj se ky raport është mjaftë i detajuar dhe shumë transparent dhe asnjëherë nuk na është afruar në këtë formë, dhe i falënderoj të gjithë për punën e bërë në këtë raport.

Afrim Limani – Kryetari gjatë prezantimit të raportit të punës e prezantojë vetëm raportin financiar dhe të them të drejtë unë kam pritur ma tepër. Për dallim nga kolegët e mijë që e kanë lavdëruar raportin unë kam vërejtje të shumta dhe ky raport për mendimin tim nuk është aspak i mirë dhe tash do i ceki arsyet. Raport ka gabime të shumta teknike drejtshkrimore dhe mos barazim të të hyrave të drejtorive në raport me raportin financiar. Përveç Drejtorisë së kulturës dhe të shëndetësisë që i përputhet raporti. Në faqe të parë duhet të shkruhet raport vjetor i punës sepse edhe ashtu është, dhe në faqen e dytë duhet të shkruaj se raport i cilit vit është, për cilën periudhë flitet. Që në fillim një fjali ku shkruan: Me rastin e pranimit zyrtarë të detyrës për udhëheqjen e komunës së Rahovecit shpresat ishin minimale për menaxhim të suksesshëm për shkak të borxheve, dhe mendojë se kjo nuk është dashur të shkruhet kështu sepse ju jeni betuar që çfarëdo sfide që do ta kesh do ta tejkalon. Takimet e vazhdueshme me donatorë të huaj për tërheqjen e investimeve, dhe unë kam një pyetje se a keni fituar ndonjë donacion dhe pse në raport nuk është e prezantuar, nëse ka pasur është dashur të prezantohen. Konsultimet e vazhdueshme me komunitetin e biznesit të tregtarëve dhe zejtarëve, unë nuk e di a keni pasur ndonjë takim dhe nëse e keni pasur atëherë është dashur të prezantohet tek pjesa e aktiviteteve. Po ashtu kemi edhe përballje me sfidën dhe pastrimin e ambientit, dhe unë kam përshtypjen se në këtë drejtim fare nuk është bërë asgjë sepse gjendja është për mjerim me mbeturinat ngurta në çdo hyrje të Rahovecit. Tek stabilizimi i rrjedhave të arsimit të komunës dhe përmirësimi i infrastrukturës mësimore, unë këtu nuk kam çka të flasë sepse e dimë të gjithë se si ka kaluar arsimi brenda këtij viti. Tek pjesa e aktiviteteve unë i kam parë disa aktivitet që nuk është dashur fare të futen në raport, është në rregull që i ke prezantuar ditën e festivalit të vjeljes së rrushit por ke harruar të prezantosh ditën e eksportit Kosovar në Qendrën grumbulluese për pemë dhe perime sepse ajo është një shpëtim për bujqit e komunës së Rahovecit, në momentin kur ka filluar mbledhja e produkteve bujqësore bujqit tanë gjithmonë i kanë shitur produktet e veta. Tek Drejtoria e administratës, drejtori i ka prezantuar të hyrat deri në muajin nëntor por jo edhe të hyrat e muajit dhjetor. Tek Drejtoria për kulturë, rini dhe sport, raporti i kësaj drejtorie më ka pëlqyer sepse është raport i kompletuar si nga ana tekstuale ashtu edhe tabelare, por tek pjesa e subvencioneve dhe tek sfidat e fundit është dashur ta qes

edhe ndërtimin e skemës së festivalit “Anadrija jehon”. Konsideroj se tek KF “Rahoveri” ka ndarë shumë pak mjete e që është dashur të subvencionohen. Te KF “Rahoveci” 14.550.00 € të themi realisht ndoshta është pak por nëse e krahasojmë me klubin “18 Korriku” i cili i ka 1.900 € nuk është edhe shuma e vogël është dashur ti shtohen edhe disa mjete. Po ashtu edhe raporti i Drejtorisë së shëndetësisë më ka pëlqyer shumë sepse është i kompletuar me të dhëna. Tek Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim drejtori i ka prezantuar të hyrat nga qiraja të them të drejtën unë jam munduar ti kuptoj, kemi këtu një tabelar dhe ja fillojë me Sabina Durguti, për vitin 2013 është 820 € pagesa, në 2014 është po ashtu 820 € e saldo do të thotë 2014 është 2460 €, atëherë në bazë të këtyre tabelarëve saldo duhet ti figuroj që për 2014 zero Euro. Tek Drejtoria për financa, raporti i punës i kësaj drejtorie nuk është raport i punës por raport financiar sepse këto të dhëna janë edhe në raportin financiar. Ka pasur edhe anët e mira që është dashur të prezantohen por nuk janë prezantuar, ndërsa sa i përket anës tekstuale të këtij raporti është e mirë.

Feim Fetoshi, Dr.SH.P – Do nisem nga pyetja e fundit që e bëri Afrimi, për mbeturinat inerte që janë nëpër hyrje të Rahovecit. Absolutisht ka të drejtë dhe po ashtu ky është edhe shqetësimi ynë, ne nuk kemi pas mundësi të intervenojmë në atë drejtim sepse na ka ndaluar ligji. Në këtë vit përkundër vështirësive buxhetore që i kemi ne kemi ndarë mjete për atë problematikë dhe sivjet nuk do të bëhet vetëm pastrimi i asaj zone, por do të xhindet një zgjidhje afatgjate. Rasim Fazliu pyeti lidhur me një rrugë në Krushe të Madhe që duhet të asfaltohet dhe thotë se nuk figuron fare në raport shifra. Arsyeja pse nuk figuron është sepse ky projekt për vitin 2014 nuk ka qenë në plan, është projekt nga 2012 që ka mbetur dhe ne e dimë rëndësinë e asaj rruge dhe qysh në vjeshtë kemi filluar me u marrë me atë punë dhe e kemi qitur në linjën buxhetore, operatori ka filluar në vjeshtë që ta ndërtojë këtë rrugë, po për shkak të disa problemeve që i kemi pasur me banorët e Krushës së Madhe, nuk kemi mundur me e finalizuar rrugën por mjetet janë të rezervuar për atë rrugë diku 44,562.00 €. Sinan Bajraktari pyeti për kanalizimin në Palluzhë, Sinan ju e dini se disa rrugë gjatë dimrit janë prishur dhe ne kemi intervenuar, kemi sjellë operatorin që t'i rregullojë dhe po ashtu operatori ka për detyrë që ti kthejë rrugët në gjendjen e mëparshme. Bahtjari ka pyetur për rrugën e fshatit Bobovc. Përkundër që Bobovci është një lokalitet shumë i vogël ne jemi në dijeni se ata banorë e gëzojnë të drejtën për një infrastrukturë të mirë dhe shumë shpejtë do ta kenë, por duhet të jemi real dhe situatën financiare e dini si është dhe fshati Babovc nuk mundet të jetë prioritet para disa lokaliteteve të mëdha. Ajo rrugë shumë shpejt do të shtrohet me zhavorr ndërsa nuk mundemi të ju premtojmë se do të shtrohet me kubëza këtë vit sepse nuk kemi mjete financiare, unë e kisha lutur Bahtjarin sepse e di se ka ndikim në tek ata banorë që mos të hedhin plehra në rrugë dhe me e lutë një banorë që ta lirojë rrugën sepse e ka qitur një rrethojë 1 metër në rrugë edhe pse ndoshta është pronë e tij, mirëpo së paku deri sa të definohet rruga le ta liroj. Besniku pyeti në lidhje me çështjen e trotuareve dhe cilat janë projektet e reja. Sivjet në Ratkovc do të rregullohet një pjesë e trotuarit nga ura e lumit që është në Ratkovc nëpërmjet lagjes së ashkalive dhe deri te trotuari që është tek rrethi. Shpresojmë se do të kemi mjete financiare dhe mbështetje nga Ministria e infrastrukturës, sepse ajo rrugë është në kompetencë të sajë. Do të risim sipërfaqen e trotuareve. Rukija pyeti për mbeturinat unë i dhashë këtë përgjigje Afrimit. I nderuari Ejup, sa i përket ujësjellësit në fshatin Reti keni të drejtë, ne vitin e kaluar kemi gjetur një projekt të përgjysmuar dhe nuk kemi pasur buxhet për ndërtimin e basenit dhe në këtë vit i kemi marrë të gjitha masat që të fillojë ndërtimi atij baseni dhe besojmë se edhe “Radoniqi” do e kryej punën e vetë të përgjegjësisë dhe me shpresë se deri ka fundi i vitit edhe fshati i Retisë do ta ketë ujin e Radoniqit. Kolegu Përparim pyeti për rrugët në fshatin Apterushë ku thotë se në Apterushë nuk është punuar fare. Ai po e thotë një të pavërtetë të madhe sepse në fshatin Apterushë është punuar mjaftë, është punuar segmenti i rrugës që e lidhë me fshatin Reti, në Apterushë gjatë kohës kur ka qenë Përparimi drejtor kontrata ka vlerë 338,233.00 € dhe i ka dhënë presion punë kryesit që me mund me marrë ndonjë votë janë punuar diku rreth 65% të punëve dhe i ka paguar vetëm 8% të parave ndërsa ne vjet i kemi paguar për këtë kontratë 100.000 €. Po ashtu vitin e kaluar kur i kam inspektuar ato rrugë kam parë që janë shtruar rrugët që nëpër ato shtëpi nuk banojnë askush, ndërsa një familje që i ka dy persona në karrocë, paralizë, e atë rrugë nuk e kanë shtruar dhe unë betohem sot para jush se atë rrugë këtë vit do të rregullojmë.

Fehmi Hoxha, Drejtjori i Urbanizmit – Tek pyetja që e bëri Rasimi për lumin “Dullo” kontrata ka qenë 1,137,929.71 €, është nënshkruar në vitin 2012, është kontratë 3 vjeçare dhe sivjet me 06.08.2015 skadon afati. Janë paguar deri me sot 821.000 €, kanë mbetur pa paguar 316.000 € ne në vitin 2014, kemi marrë një iniciativë e kemi ftuar edhe operatorin ekonomik dhe kemi kërkuar që të largohet një pozicion nga projekti i cili ka qenë rrënimi dhe ndërtimi i parkut të qytetit në vlerë 117.000 € Kemi nënshkruar memorandumun e mirëkuptimit që nuk ka nevojë të rrënohet parku ekzistues, pra borxh kemi tash vetëm edhe 200.000 € dha çka ka mbetur të bëhet ka mbetur kanalizimi prej “Vrellës” që duhet të largohet nga shtëpitë sepse ende derdhet në lumin “Dullo”. Po ashtu kam për obligim si anëtar i Art Studios ti them Fatmiri se nuk qëndron që 6.000 € i janë paguar Art Studios, 2.000 € me vendim të kryetarit janë paguar 2014, po ashtu edhe në 2013 ka qenë 2.000 €, ndërsa 1,450 € janë paguar shpenzime shtesë për ushqim dhe fjetje për 63 artist ndërkombëtarë dhe që rezultoi 3.450 € për aktivitetin e kolonisë së artistëve, si dhe Art Studios i janë paguar 500 € dhe me këto janë organizuar edhe shpallja e sportistit të vitit, projekti ka kushtuar 8.000 € një pjesë prej donatorëve dhe një pjesë prej Ministrisë së Kulturës.

Avdullah Kryeziu, Drejtor i Ekonomisë – Rreth pyetjes që e bëri Rukija për të hyrat nga qiraja dhe gjoja për disa biznese të favorshme të qeverisë komunale. Unë ju them se në vitin 2014 kanë qenë të planifikuar 45.000 € për të hyrat nga qiraja dhe janë realizuar 50,600 €, pra e kemi tejkaluar planifikimin, dhe sa i përket bizneseve të favorshme unë mendoj se qeveria komunale dhe kryetari nuk ka pasur biznese me favorizime. Po ashtu ne jemi ballafaquar me probleme të ndryshme në vitin 2014 dhe ju them se ish qeveria komunale e ka shkel ligjin sepse ka vazhduar kontrata jo konform ligjit. Kadri Dellova pyeti se a kemi ndonjë strategji për mbledhjen e borxheve. Normal se çdo qeverisje komunale ka strategjitë e veta për mbledhjen e borxheve. Ne 4 herë ju kemi shkruar bizneseve me shkresa zyrtare dhe kemi kërkuar që ata ti kryen obligimet e veta. Fatmir, edhe një herë po të them se mirë është që e ka bërë raportin me SWAT analizë, por unë prapë e kam atë mendimin se nuk është SWAT analizë sepse SWAT analiza i ka përparësitë, dobësitë, rreziqet dhe rezultatet, ndërsa ky raport ka aktivitete mujore, numrin e takimeve që ka pasur, pjesëmarrja në takime zyrtare dhe në fund normalisht prezantohen rezultatet e punës: Afrimi ka të drejtë për vërejtjen por ne vetëm i kemi qitur borxhin që ekziston, po ashtu në kontrata që i ka nënshkruar ish kryetari ka pasur shkelje të ligjit, diku na del se ma tepër ne paguajmë shpenzime për biznesin se sa biznesi që i paguan komunës për qira.

Munib Durguti, Drejtor i Shëndetësisë – Doktoresha pyeti rreth marrëveshjes me Caritasin se a do të ketë shërbimet e tija. Ne i kemi sqaruar këtë çështje dhe prej 1 marsit ne do të startojmë me këtë shërbim dhe kujdesi shtëpiak do t'i afrohet të gjitha atyre që janë të hendikepuar dhe rastet e tjera në nevojë. Po ashtu marrëveshjen e nënshkruar me përmbajtje të njëjtë si të 2014-ës, mirëpo Caritasi nuk ka qenë i gatshëm që ta ofrojë një automjet i cili do të jetë në shërbim të këtij projekti, po ashtu aty parashihihen edhe disa trajnime për stafin i cili do t'i kryej këto shërbime. Tek pyetja për certifikatë shëndetësore për patentë shofer, në vitin 2013 është nxjerrë Udhëzimi administrativë prej ministrit të shëndetësisë Nr 04 2103 neni 8 paragrafi 3.1.1 i cili e përcakton komisionin të cilin duhet të ketë çdo komunë apo secila QKMF pa të cilin nuk mund të lëshohen këto certifikata. Pra, përbërja është doktori i mjekësisë familjare, oftamologu, neurologu, psikiatri dhe psikologu. Komuna jonë nuk i ka këto kuadro, dhe me të njëjtin udhëzim është përcaktuar që një komision duhet t'i shërbejë një komunë, ngase ka qenë një praktikë në të kaluarën që i njëjti person të jetë i përfshirë në Podujevë, Prizren në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën ditë, dhe për atë arsye aty kemi rënie në participim në vlerë prej 5.000 €. Te pyetja për rëntgen, ne kemi shpallur një tenderë për rregullimin e rëntgenit dhe arsyeja sepse na ka lojë viti pa rëntgen, kemi pasur një shkurtime të buxhetit në mallra dhe shërbime në 15 % dhe në anën tjetër ne nuk kemi hasur në një kontratë për mirëmbajtje të pasjeve medicinale dhe nuk kemi mundur me e nxjerrë një kodë për riparimin e kësaj aparature. Sa i përket personelit i cili ka qenë i angazhuar në rëntgen ne nuk kemi ndonjë vendim me të cilin janë sistemuar ata, mirëpo ata kanë qenë të angazhuar me sektorin e vaksinimit në participim etj. Rukija bëri një pyetje se pse ka ngecje në QMF dhe AMF në Polluzhë dhe Brestovc. Ka qenë një vakum 2 javë sepse i kemi ndarë specializime 4 mjekëve dhe ata e kanë pas afatin e fundit ku është dashur të paraqiten si specializantë, ndërsa prej 1 shkurti ne i kemi 4 mjekë të ri që janë në marrëdhënie të përhershme pune dhe i kemi mbuluar këto pika, përveç Optrushës i cili objekt ju e dini ka qenë në riparim dhe presim që operatori të bëjë një kërkesë për pranimin teknikë dhe pastaj do të funksional edhe ky objekt. Fatmiri ka ngritur një çështje për kilometrazhin. Arsyeja qëndron në disiplinimin e stafit, dhe shumë mirë e tha se si mundet një veturë më e vjetër me shpenzua ma pak. Ne kemi kaluar 5.000 km ma shumë ndërsa kemi shpenzuar 740 L ma pak, pra kjo qëndron tek disiplinimi i punëtorëve por këtë pyetje ai është ma mirë të i ja bëjë Florijes si ish drejtoreshë e shëndetësisë dhe besoj se ajo e ka shpjegimin se pse ka lejuar që shpenzimet e tilla të ndodhin në këtë sektorë. Tek participimi realisht ne kemi një rritje duke marrë parasysh që nuk e kemi pasur komisionin për dhënien e certifikatave shëndetësore për patentë shofer, ne kemi rritje rreth 1.440 € për vitin 2014 pra ne e kemi tejkaluar edhe mungesën e rëntgenit.

Behar Rama, Drejtor i Arsimit – Pyetja ishte rreth numrit të madh të mungesave por unë e them të kundërtën se numri ishte i vogël i mungesave në krahasim me vitin e kaluar, dhe sipas statistikave që i kamë numri i mungesave në shkollat e mesme është më pak për 9696 mungesa, ndërsa në shkollat fillore prej klasës së 1-5 për 2962 mungesa. Gjithsej në shkollat fillore dhe të mesme në krahasim me vitin e kaluar të gjysmë vjetorit të parë janë për 5590 mungesa më pak. Sa për kureshtje muajin e fundit kemi pasur vetëm 8 mëditje pa arsye për mësimdhënës, ndërsa në muajin e parë kur kam ardhë si drejtorë kanë qenë 68 mungesa të mësimdhënësve dhe ju kemi hequr mëditjet.

Kryesuesi – Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë me ligj nuk parashihiet aprovimi i raportit të punës i Kryetarit.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit komunal për efikasitet të energjisë – PKEE 2015-2020,

Feim Fetishi – Me planin komunal për efikasitet të energjisë komuna jonë përmbush obligimet nga Ligji për efikasitet të energjisë Nr.41/016 neni 9 i cili e obligon komunën që të ketë Planin për efikasitet të energjisë. Ky plan është punuar nga Kompania Bit Fox, një kompani Kosovare-Italiane. Më lejoni që ne emrin e juaj dhe të kryetarit ta falënderoj menaxherin e kompanisë z. Ramadan Suka për gatishmërinë që ka pasur që tërë këtë punë për kuvendin komunal ta bëjë si donacion. Ky plan para se me ardh në Kuvend ka qenë edhe në Agjensionin Kosovar për Efikasitet të Energjisë, i cili po ashtu ka marrë dritën e gjelbër si një planë i mirë dhe konform Ligjit dhe strategjisë kombëtare për efikasitet të energjisë. Prej këtij plani dalin shumë obligime tona, njëri obligim është që komuna duhet të merr hapa për implementimin e këtij plani, po ashtu të krijojë një zyre komunale për efikasitet dhe personin përgjegjës të energjisë. Rrjeti ajror në qytet sugjerohet që sa ma shpejtë që është e mundur të zëvendësohet me rrjetin nëntokësorë, izolimi i objekteve komunale, afariste dhe private, mundësisht të kenë izolime termike si të mureve ashtu edhe të çatave, shfrytëzimi i dritareve të jetë me term izolim 2 dhe 3 shtresor. Po ashtu edhe rinovimi i sistemeve të ngrohjes kaldaja duhet të zëvendësohen me kaldaja eficiente, duhet të fillohet me sisteme foto voltatike në komunën tonë. Po ashtu duhet të fillojmë me panele solar të ujit dhe posaçërisht ndriçimi publik. Duhet të jenë eficientë dhe trupat aktualë të zëvendësohen me trupa eficientë. Na pretë shumë punë por besoj se është një hapë i mirë në drejtimin e duhur.

Lirih Berisha – Energjia është njëra prej problemeve kryesore të këtij shekulli dhe më vije mirë që kemi filluar që të bëjmë një energji ranograme sidomos me panel të diellit. Unë kam një pyetje se a ka parapa qeveria komunale ose organizatat që t'i ndihmojnë atyre njerëzve që donë t'i vendosin penelat solar dhe me çfarë përqindje do të jetë ajo.

Kadri Dellova – Kryesues kam disa vërejtje tek ju dhe disa drejtorë dhe nuk ju shkon në sensin e juaj sepse jeni një politikan edhe para lufte edhe pas lufte që të paragjykon i pa e lexojmë apo nuk e lexojmë materialin. Unë flas për vete, gjithmonë jam i koncentruar paraprakisht për materialin që vjen

dhe prezantimi i drejtorëve për punën që e bëjnë kanë përgjegjësi ligjore për raportimin e punës. Sa i përket efikasitetit unë e kamë një raport shumë të detajuar, por më brengos te konsumatorët enorm, parku i qytetit si dhe konsumatorët ma të mëdhenj nga ndërtesat arsimore edukative janë shkolla e "Faik Konicës" Celinë dhe shkolla e Hoçes së Madhe si dhe shkolla në Dabidol. Duke pasur parasysh numrin e nxënësve që kanë këto shkolla dhe sipërfaqen e objektit si është e mundur që shkollat si "Mihal Grameno", "Isa Boletini", "Bajram Curri", "12 Maji" në Ratkovc dhe "4 Dëshmorët" nuk kanë kesi shpenzime të rrymës a mos kemi rastin që njëhisorët e shtëpisë i kanë këqyr në njëhisorë të shkollave.

Kryesuesi - Unë atë që e thashë, e thashë me plotë vetëdije dhe pa paragjykim, sepse një pjesë e delegatëve është e vërtetë që nuk e lexojnë materialin, ishte fjala tek tabelat, është e vërtetë se nuk po shihen në materialin fizik që e kemi dërguar por ai i cili ka dashtë ta shih ka pasur edhe materialin elektronikë.

Selim Duraku – Plani komunal për efikasitet të energjisë a do të jetë vetëm për ndriçimin publik apo në të gjitha sektorët, po ashtu tek efikasiteti a do të jetë vetëm tek dritat led apo ka edhe produkte tjera, si bateria apo nxehje solar, kisha dashtë një sqarim.

Ejup Kabashi – Unë mendoj se të gjitha iniciativat që mirën për kursimin e energjisë elektrike janë në të mirën e vendit. Kam një pyetje konkrete, si do të jetë plani operativ se si do të realizohet gjithë ky projekt, sa do të jetë kostoja e saj.

Rukije Krasniqi – Me të vërtetë është një projekt shumë i mirë sepse është edhe kursim nga ndotja e ambientit të cilin ne e kemi nëpër shkolla për nxehje qendrore që është Lignit që përdoret, i cili liron një sasi të madhe të monoksidit të karbonit, ajo nuk është e dëmshme vetëm për fëmijët që janë në shkollë, por është e dëmshme për gjithë lagjen, dhe unë mendoj se ky projekt është për tu përkrahur, është për tu admiruar sepse është një energji e cila nuk është e dëmshme.

Bahtjar Hoti – Unë nuk e di se pse jeni duke e zgjatur ky projekt duhet të votohet.

Ramadan Suka, Menaxher i kompanisë Bit-Fox – Plan komunal për energji eficiente është një plan që është obligativ thuhet për të gjitha komunat në Kosovë, kështu që të kenë mundësi të gjitha komunat të përkrahen nga qeveria, sepse pa plan komunal për energji eficiente nuk mundemi me e tërheq asnjë donacion. Ne, së bashku me komunën do të punojmë që të përkrahim edhe me projekte të tjera. Një asamblist e shtoi pyetjen se çka kërkojmë me energji eficiente. Me energji eficiente nuk kuptohet vetëm kursimi i rrymës elektrike, por eficientë është edhe izolimi i objekteve me anë të stiropolit, me anë të dritareve izoluese, pra mundë të themi se kjo përfshin një energji eficiente. Po ashtu me anë të paneleve mundë të bëjmë edhe rrymën, kështu që është një kursim shumë i mirë i rrymës dhe më i shëndetshëm.

Selim Duraku – Tek ndriçimi publikë eficienta do të jetë vetëm tek drita led apo do të ketë edhe bateri shtesë ose do të jetë me solar.

Ramadan Suka – Me anë të ledit është kursimi i rrymës, por mënyra tjetër është edhe që të shkohet edhe me anë të panelet solar si p.sh. vendet ku nuk ka rrjetë elektrike është shumë me rendësi dhe më e lehtë, sepse nuk ka nevojë instalimi i rrymës dhe shkojmë drejtpërdrejtë me anë të paneleve, baterive dhe shtyllave, ndërsa në qytet nëse është rrjeti ekzistues mundemi të shkojmë vetëm me ndërrimin e trupave ekzistues me anë të ledit.

Kryesuesi – Besoj se keni marrë informacion të mjaftueshëm e qesë në aprovim? Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar janar-dhjetor 2014.

Lulzim Sylejmani, Drejtor i Financave – Sipas ligjit 03 L 048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi duke respektuar nenin 45 dhe 46 jemi të obliguar që të raportojmë në 3 mujore dhe raportin vjetor financiar. Sipas pikës 46.2 të nenin 46 kryetari komunës konkretisht Drejtoria për financa buxhet është obligative të dorëzojë Kuvendit një raport financiar më së largu deri me 31 mars të vitit pasues. Sa i përket buxhetit të vitit 2015 ne si drejtori e financave kemi pas një mori sfidash dhe një buxhet të pa aprovuar, obligime të faturuara mbi 2 milionë euro, obligime të pa inkasuar sa i përket të hyrave vetanake të qytetarëve dhe po ashtu njëri prej sfidave ka qenë edhe aprovimi i buxhetit 2015, duke u munduar t'i respektojmë të gjitha kontratat ekzistuese dhe obligimet që i kemi gjet. Shkurtimi prej 15% në mallra dhe shërbime po ashtu ka qenë një sfidë e jona, pasi që ne jemi munduar që t'i reduktojmë disa shpenzime që më shumë quhen shpenzime të luksit, ku kemi kursyer në shpenzimet e telefonit, materiali administrativ, ë karburante të veturave si dhe shkurtim të shpenzimeve në mëditje dhe udhëtime zyrtare. Po ashtu edhe herëve të kaluara që kemi raportuar e kemi qartësuar çështjen e obligimeve në fund të vitit 2013. Gjatë vitit 2014 në investime kapitale kemi paguar 1.700.000 €, fatura të cilët kanë qenë me 31.12.2013 nga 3.3 milion euro sa ka qenë buxheti në investime kapitale, dhe nga opozita prapë vinë zërat kritikë se nuk është punuar me marrë në përqindje 51% e buxhetit për 2014 që ka qenë për investime kapitale ka shkuar për pagimin e borxheve të vitit 2013. Gjatë raportimit të raportit financiar 9 mujorë deputetët kanë pas shqetësime lidhur me suficitin që mundë të jetë në buxhet në raportin tonë financiar. Shpenzimi i buxhetit si total është 98.74%, jemi në mesin e komunave me shfrytëzimin më të mirë të buxhetit në nivel Kosovë. Sa i përket realizimit të të hyrave, planifikimi ka qenë i vitit 2013 në vlerë prej 950.000 € ndërsa është realizuar 1,175,39.62 € ose 107.11% të buxhetit të planifikuar të të hyrat vetanake. Po ashtu në të hyra kemi rritje të disa sektorë nëse e shohim inkasimin e të hyrave dhe e krahasojmë me 2013, në disa pozicione kemi rritje e të hyrave, si në qira të lokaleve, taksa të bizneseve, tatim në pronë dhe në disa pozicione tjera. Po ashtu është e vërtetë se ka edhe shumë obligime ndaj komunës, por strategjia jonë është që këto obligime t'i zvogëlojmë me gjitha masat e nevojshme duke i respektuar edhe ligjet me vërejtjet që duhet t'i dërgojmë, por tash e kemi edhe një lehtësim të madh me anë të përmbaruesve privat. Raporti financiar është shumë transparent dhe janë të respektuara të gjitha rregulloret dhe ligjet në fuqi dhe është i detajuar për secilin shpenzim.

Selim Duraku – Kam një pyetje tek krahasimi i të hyrave dhe tek qiraja e objekteve publike është minus 10.000 € kërkoj sqarim prej drejtorit ku është problemi. Po ashtu tek realizimi i të hyrave të tatimit në pronë ku kemi 214 objekte 35,409 m², është çmimi i njëjtë me vitin 2014 që janë 505 objekte dhe i bie dy herë ma shumë, si mundë të jetë i njëjti çmim. Tek paraqitja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime, tek nafta, thëngjilli dhe dru për ngrohje, janë harxhuar më pak këtë vit afër 54.000 €, a është kjo menaxhimi i mirë i kësaj qeverisje ose keq menaxhimi i qeverisjes së kaluar.

Azbi Gashi – Fillimisht kam një vërejtje tek të hyrat ku thuhet për periudhën janar - shtatorë ndërsa në tabelë është vjetore, besoj se është ndonjë gabim teknikë. Po ashtu tek regjistrimet e reja të objekteve e ceku edhe kolegu ku 214 objekte janë në vitin 2013 ndërsa në vitin 2014 janë 505 objekte, ndërsa faturat janë shpërndarë me shumën e njëjtë si është e mundur kjo. Edhe borxhet janë si në vitin 2013 ashtu dhe në vitin 2014 dhe arsyeja për mospagesë është fundviti edhe kjo si është e mundur, dhe në fund kam një pyetje për drejtorin: këto borxhe që kanë mbetur prej 2013 a ka bazë ligjore apo nuk kanë dhe nëse nuk kanë bazë ligjore pse nuk i drejtoheni gjykatës dhe nëse nuk jeni në gjendje ta bëni ju atëherë na servoni materialin dhe ne do e kryejmë këtë punë.

Fatmir Iska – Për periudhën raportuese të raportit financiar 9 mujorë i kam cekë shumë arsye dhe fshehje të shpenzimeve që i kam treguar me fakte dhe argumente dhe arsyetimi ka qenë gabim teknik, mundë të ndodh në një kolonë, por jo çdo shpenzim i çdo kodi. Fatkeqësisht prapë po e shoh të njëjtën fshehje të shpenzimeve që ka komuna për këtë raport vjetor financiar. Tek fq. 4 tabela nr. 2 të dhënat përmblendhëse dhe krahasimi i tyre për periudhën 2010/2014 shumë mirë i keni të pasqyruara këtu sa i përket të hyrave vetanake që i ka realizuar komuna. Shumë mirë që kemi tejkalim e të hyrave në vitin 2014 për 67.000 €. Por, nëse marrim një krahasim edhe në vitin 2011 kemi pasur një rritje prej 96.000 €. Unë do ju argumentoj se pse kanë ndodhur këto rritje në 2014. Në

2012 kemi zvogëlim për 30.000 €, po ashtu edhe periudha krahasuese 2013 mbetet e njëjtë dhe në 2014. Nga periudha krahasuese sipas këtij tabelori kemi rreth 50.000 € rritje. Të hyrat vetanake janë realizuar jo për shkak se janë munduar drejtorët së bashku me Kryetarin, por këto të hyra janë realizuar pikërisht nga gjobat nga gjykata si dhe gjobat e trafikut. Nëse marrim periudhën krahasuese 2013-2014 gjobat në trafik në 2013 kemi 23,706.00 € ndërsa në 2014 kemi 102,962.00 €, pra diku rreth 80.000 € rritje. Pra, kjo është mirë e dikujt tjetër dhe assesi e ekzekutivit të komunës. Te gjobat e gjykatave në 2013 kemi 91,617.64 € ndërsa në 2014 kemi 137,212.95 €, pra kemi një rritje pre 45.000 € që edhe kjo është e mirë e dikujt tjetër. Po ashtu në faqe 7 janë raportuar të hyrat që janë realizuar në bazë të kodeve, ndërsa tek faja 9 ku në 2013 kemi regjistrim të objekteve 2014 sipërfaqe 35.491 m2 vlera e faturuar për 2013 është 324,712.68 €, ndërsa faturat e shpërndara 11.620.00 €, ndërsa në 2014 kemi 505 objekte të regjistruara me hapësirë 90,134 m2 vlera e faturuar 324,752.91 €, që është e njëjtë me periudhën krahasuese të vitit 2013, ndërsa faturat shpërndara në 2014 kemi 12.670.00 €, pra kemi edhe një herë më shumë objekte të regjistruara, po ashtu dy fish metrash katror më shumë ndërsa vlera figuron e njëjtë. Te faqe 17 tabela 8 janë të përcaktuar sipas kodeve të gjitha shpenzimet që janë bërë dhe drejtori thotë se ne i kemi shkurtuar shumë shpenzime dhe thotë posaçërisht në mëditje dhe udhëtime. Në 2013 kemi mëditje 19.804.00 € ndërsa në 2014 kemi 19,052.00 €. Pra, unë nuk pe shoh kurrfarë shkurtimi këtu. dua të lidhem me periudhën krahasuese të raportit financiar që ka qenë në 2012/2013 dhe raportin e 2014, mendoj se vetëm është dashtë të merret kolona copy paste të 2013 dhe të bartet në 2014. Në bazë të atij raporti financiar 2012/2013 ku merret periudha krahasuese, po e potencoj në bazë të kodeve sa kanë qenë në rritje dhe sa janë reale në periudhën 2012/2013, në kodin 13,130-43 mëditjet e udhëtimit i kemi pas 19,549.00 €, ndërsa këtu pasqyrohen në 2013 janë 19,804.00 €, pra diku rreth 300 € më tepër. Te kodi 13.320 shpenzimet e telefonit kemi 8,143.36 € ndërsa në periudhën 2012/2013 që është pasqyruar kemi 7,468.00 € që do të thotë diku rreth 600 € më shumë janë pasqyruar se sa në bazë të atij raportit. Tek shërbimet kontraktuese kodi 13.460 në periudhën e vitit 2014 kemi 30,965.00 € ku kemi një rritje rreth 54.000 €. Në kodin 13.470 shërbimet teknike të vitit 2013 që lidhen me periudhën 2012/2013 të raportit krahasues, kemi pas zero shpenzime ndërsa këtu na figurojnë sipas këtij raporti 1,341.65 €. Tek mobile kemi një rritje në periudhën krahasuese 2013/2014 rreth 9,216.00 €, tek kodi 13.503 tek kompjuterët kemi 5,729.00 € që janë pasqyruar në këtë periudhë krahasuese të vitit 2014 ndërsa në raportin 2012/2013 kemi 4,733.00 € që do të thotë kemi një rritje prej 1.000 €. Pra, gjithnjë po flas në bazë të raportit financiar të periudhës krahasuese që ka qenë dashtë me qenë në këtë kolonë copy paste dhe as të shtohen ose të hiqen nga ky kod. Tek kodi 13.620 furnizim, ushqim dhe pije, prap kemi zero €, ndërsa këtu na pasqyrohen 3,553.95€, gjithashtu furnizim ushqim dhe pije në kodin e njëjtë kemi 1,237.00 € ndërsa sipas atij raporti është zero €. Tek kodi 13.640 furnizim higjienë 22 kemi zero €, ndërsa në 2013 sipas këtij raporti kemi 1,734.49 €. Tek nafta për ngrohje për periudhën krahasuese janar-shtator 2013 kemi pas 25,709.00 € ndërsa për 3 muajt e fundit të vitit 2013 kjo shumë ka kaluar në 118.000 €, ndërsa në 2014 rritet nga 36.000 € dhe kjo zërbërhet në 3 kode që i përfshin 13,720.00 €, dhe diku e kapë vlerën rreth 75.000 € ose kjo mund të jetë edhe fundi i vitit që i bëhet pagesa operatorëve. Tek kodi 13.750 kemi thëngjill që përfshin 3 kolona në të tre kolona kemi zero €, ndërsa këtu na pasqyrohet një obligim 301 €, 570 € dhe 1.800 € dhe sipas mendimit tim nuk duhet të figurojë sepse nuk është ashtu. Tek karburant për vetura kodi 13.780 kemi 6,223.51 € për periudhën 2013 gjithnjë sipas këtij raporti, ndërsa sipas raportit tjetër kemi zero €, pra do të thotë vlera që ka qenë 57,426.00 € ajo qëndron, mirëpo kjo vlerë tjetër në kolonën e kodit të njëjtë është shtuar dhe nuk është dashur të figurojë. Tek regjistrimet e automjeteve nuk do të ndalem sepse ajo lidhet me afat kohor. Tek mirëmbajtja e shkollave 2014 kemi 54,742.62 € do të thotë kemi një zvogëlim prej periudhës krahasuese 2013 që ka qenë 63,228.00 € që është mirë. Tek kodi 14.310 dreka zyrtare gjithnjë sipas periudhës krahasuese 2012/2013 ka qenë 10,643.00 € ndërsa tani kemi në këtë raport në 2013 po të njëjtën periudhë 12,941.30 € që do të thotë kemi një rritje pre 2.300 € më tepër. Në kodin e fundit 14.410 kemi shpenzime sipas gjykatave në 2013 sipas këtij raporti kemi 16,056.68 €, ndërsa sipas raportit 9 mujor shumë prej 13,388.00 €. Pra kemi një zvogëlim, nuk përputhen njëra me tjetrën, ndërsa në 2014 vlera mungon, dhe krahasimi na del përqindja 2013/2014 në vlerë kemi 693,592.00 €, ndërsa në 2014 kemi 634,577.00 € pra që do të thotë diku rreth 64.000 €. Nëse këto që i përmenda me zero vlerë që kanë qenë, janë shtuar ose janë hequr shumë dhe këtu mungojnë shpenzimet e gjykatës, atëherë si është e mundur me e pas një krahasim të raportit të shpenzimeve të periudhës krahasuese 2013/2014 sipas kësaj që na kanë servuar si mundet me qenë, kur nuk po figurojnë shumë shpenzime këtu, dhe kemi një dallim në vlerë prej 60.000 €. Dua ta përmbyllë me raportin e punës që e përmenda ma herët tek faqe 27 tabele numër 8 kodi 130 tek mallra dhe shërbime kemi në 2014 obligime të faturuara 79,795.00 € që do të thotë borxhi komunal aktual që kemi më shumë se sa në 2013 për 5.000 €. Tek shpenzime komunale kemi një rritje për 19.000 € dhe që është borxh diku rreth 50.000 €. Tek investime kapitale kemi borxhe për 2014 kanë mbetur 602.000 € që do të thotë nga ajo humbje e mos votimit e atij buxhetit të vitit 2012/2013 ishin paguar edhe këto borxhe që janë aktualisht dhe komuna kish me punuar pa asnjë centë borxh ndaj asnjë operatori.

Kryesuesi - Së pari nuk pajtohem me krahasimin që e ke bërë me 2013 sepse nuk e kanë marr copy paste dhe ta bartin kënde, ajo nuk bartet sepse nëse ju keni gabuar diku nuk do të thotë që i njëjti gabim të përsëritet përsëri.

Kryetari – Pyes Fatmirin se a e dallon vitin e buxhetit e 2013 prej buxhetit të vitit 2014, ne i kemi gjetur 2 milion e gjysmë euro, janë gjetur faturat të vitit 2013, 2012, 2011, 2010, dhe pse je duke i përmendur gjithnjë 600.000 € të vitit 2014, dhe je duke i proklamuar se kishim mundur ti fshimë borxhet. Pra buxheti i vitit 2014 është për projektet e vitit 2014 e jo për projekte të viteve të mëparshme dhe borxhet e viteve të mëparshme është dashur të fshihen me buxhetin e viteve të mëparshme, me 31.12.2013 është gjetur borxhi mbi 2,624.000 € kanë qenë planifikim të buxhetit për vitin 2014.

Afrim Limani – Raportin financiar 2014 e konsideroj si të mangët, nuk është i kompletuar me të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet që janë zhvilluar. Këtij raporti i mungon realizimi i të hyrave sipas drejtorive sepse është obligim dhe ka karakter stimulues dhe ne dëshirojmë të shohim se cila drejtori sa ka pas të hyra. Është për të na ardhur të gjithëve mirë që janë ritë të hyrat por kjo është rritje simbolike. Unë e shoh për herë të parë një tabelë që është bërë krahasimi i të hyrave nga viti 2010-2014 dhe nëse e analizojmë realizimin e të hyrave sipas viteve është për të na ardhur keq. Nga viti 2010-2014 kemi realizim maksimum 100.000 € dhe ja sa ka ecur ekonomia jonë që nga viti 2010. Kam një pyetje për drejtorin i cili në fillim të mandatit ka thënë që si sfida do ta kem realizimin e borxheve sidomos të tatimit në pronë dhe unë e pyes se sa e ka realizuar këtë borxh. Buxhetit, është i paraqitur shumë

mirë por nuk ka pas nevojë të ketë dy shtyllat e fundit zotimet dhe mjetet e lira sepse është raport vjetor dhe në raport vjetor nuk kemi as zotime dhe as mjete të lira. Shuma e mjeteve që ka shkuar në suficit është rreth 18.000 € dhe konsideroj që nuk është shumë e madhe por ka mundur edhe këto ti shfrytëzoj. Tek donacionet kemi total 29,764.00 € nuk e di se a ka pas tjera. Tek pjesa e shpenzimit të buxhetit sipas mallrave dhe shërbimeve kam një raport që e kam nxjerr deri sa kam qenë drejtor dhe nëse e krahasojmë ka një diferencë në shpenzime afër 30.000 €. Në raport është paraqitur 693,000 € dhe 671.000 € dhe këto janë shënimet që i kam unë, shoh se për dreka zyrtare është ngritur vlera, në raportin tim që e kam nxjerr kanë qenë 10.643.00 € ndërsa këtu në këtë raport janë 12,941.00 €. Tek pjesa e raportit të zyrës së prokurimit mungon vlera e kontratës dhe pagesa. Në të ardhmen të futen edhe këto 2 shtylla dhe të kemi të qartë se sa është lidh kontrata, sa është paguar dhe sa kanë mbetur pa paguar.

Lulëzim Sylejmani – Selimi pyeti për çështjen e të hyrave të tatimit në pronë, regjistrimet e objekteve që bëhen në këtë vit, i bashkëngjitet faturës në vitin vijues. Regjistrimet që ju i keni për vitin 2014 këto bashkëngjiten në faturat e vitit 2015 atëherë rritet edhe kuadratura edhe vlera e faturës vlen edhe për vitin 2013. Sa i përket se pse këto shifra janë me vlerë të njëjtë, sistemi që është i tatimit në pronë administrohet nga Ministria e financave - Departamenti i tatimit në pronë dhe ne aty nuk kemi akses. Azbi Gashi pyet për të hyrat dhe pse po shkruan mospagim në fund të vitit, disa projekte që janë aty si fatura që kanë krijuar obligime, operatorët kanë punuar por ai obligim nuk ka mundur të paguhet për shkak se nuk ka pas kod buxhetor. Sa i përket disa kodeve që kanë janë përafërsisht të njëjta tek shpenzimet të mallrat dhe shpenzimet, kolona e fundit qartë thotë obligimet e vitit 2013. Tek mëditjet nëse ja zbrit këto 1.199.00 € del 2014 shumë ma e vogël se sa 2013. Tek shpenzimet telefonit që kanë janë ma të mëdha se shpenzimet e vitit 2013, është pagesa 2.357.00 € që janë paguar fatura e vitit 2013. Asnjë rast nuk e kemi që na u është kthyer ndonjë drejtor prej udhëtimit zyrtarë me 640 € roming, asnjë faturë nuk e kemi që ka qenë dikush në udhëtim zyrtar dhe ka ndenjur vetëm një natë në Shqipëri dhe ka paguar 1.026.00 €, asnjë faturë nuk e kemi që e kemi paguar që dikush ka udhëtuar në udhëtim zyrtarë me dy ditë pune dhe ka ndenjur tek vëllai 1 javë dhe ka marrë mëditje për 1 javë, ndërsa ftesa për 2 ditë, në 2014 nuk kemi këso raste. Sa i përket shpenzimeve në karburant për vetura në vitin 2013 janë shpenzuar 63,650.00 € prej gjitha kodeve ndërsa në vitin 2014 janë shpenzuar 54.000 €. Ka vetura që kanë shpenzuar 23%, sa i përket drekave zyrtare janë transparente në të gjitha drejtoritë ku më së shumti ka Drejtoria e arsimit për shkak të organizimit që ka me arsimtarë që është për çdo vit, është dreka me mërgimtarë, dreka me Bashkësinë Islame me rastin e Ramazanit dhe disa për 8 Mars e të tjera. Sa i përket asaj që tha Afrimi se mungon realizimi i të hyrave sipas drejtorive, së paku Afrimi e dinë se cili kod nga cila drejtori vijnë të hyrat, dhe sa i përket që mungon raporti i zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura tjera herë nuk do të mungojë. Tre kode janë të realizimit të qirave publike, është shfrytëzimi i pronës publike, qiraja e vendosjes së objekteve tregtare dhe qiraja nga objektet publike dhe të tri kode duhet t'i krahasosh me 2014 ku realizimi përafërsisht është i njëjtë. Tek objektet që janë me qira kemi një rritje, kemi pas rritje dhe në taksa të biznesit në krahasim me të njëjtën periudhë. Tek pyetja e Azbiut se a kanë bazë ligjore borxhet, unë them shumë qartë se nuk ka bazë ligjore sepse sipas Ligjit të prokurimit nuk mundet të hyhet në obligime pa pas zotim.

Kryesuesi – Ju falënderoj për kontributin e dhënë për këtë pikë të rendit të ditës, kalojmë në pikën tjetër

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2014 në vitin 2015,

Lulëzim sylejmani – Sa i përket të hyrave të bartura nga kategoritë e ndryshme nga viti 2014 në 2015 ato të hyra barten ashtu si janë të realizuara në paga, mallra dhe shërbime, subvencione dhe në investime kapitale, sa i përket asaj se pse kjo shumë është e bartur ndërsa kemi borxhe kjo shumë është realizuar në muajin 12 dhe në atë muaj nuk mundet të shfrytëzohen. Kemi 6 mujorin e të hyrave nga gjykata që bëhet në fundin e vitit, pra këto mjete nuk kanë mundur të shfrytëzohen në vitin 2014 sepse nuk kanë qenë në dispozicion, pra kanë ardhur mbas përfundimit të vitit fiskal.

Fatmir Iska – Një pyetje për drejtorin lidhur me bartjen e të hyrave vetanake, ne kemi kërkuar që subvencionet të rriten në këtë drejtim a kemi të drejtë t'i bartim prej investimeve kapitale në subvencione dhe prej kategorive tjera. Po ashtu tek ky vendim kemi te kodi 11 paga dhe mëditje në vlerë prej 21,809.12 € ndërsa këtu kemi 21,890.00 € a është bërë ndonjë gabim teknik sepse nuk e dimë se cila është e saktë.

Afrim Limani – Mua më vije çudi se si e ka pru drejtori vetëm propozimet vetëm për projektet e caktuara, normalisht këtij vendimi duhet ti bashkëngjitet lista komplet e investimeve kapitale që edhe ne të japim ndonjë propozim të caktuar, por në mungesë të kësaj liste ne nuk e dimë e çka të propozojmë dhe e kisha lutë drejtorin që në të ardhmen ta bije komplet listën e projekteve kapitale. Pjesën ku propozon drejtori mundet ta hijezojë, pra ne duhet të vendosim e jo ekzekutivi. Kam një propozim që të ndahet shuma mjeteve prej 10.000 € për rregullimin e rrugës për fshatin Babovc dhe se nga cili kodë do të sigurohen këtë të drejtë të ketë drejtori që të vendos.

Kryesuesi – Unë mendoj se as drejtori dhe as ne nuk mundemi me e bërë ndryshime sepse nuk ka kod buxhetor dhe nuk është e paraparë në buxhetin e këtij viti, ndërsa ne rishikim besoj se mund të bëhet.

Afrim Limani – Ligji i financave publike dhe përgjegjësisë e lejon krijimin e një projekti të ri, nëse të kujtohet në vitin 2011 pikërisht t'i e ke dhanë një propozim dhe propozimi ka qenë renovimi i shtëpisë së arsimit, është krijuar projekti i ri, janë lëshuar mjetet dhe është kryer puna.

Lulëzim Sylejmani – Rreth pyetjes së Fatmirit se a ka mundësi që me bartje të shkojnë mjetet në subvencione. Mjete në subvencione nuk mundet të shkojnë prej kapitaleve sepse është shpenzim operativ. Edhe pse nga viti 2014 në 2015 i kemi prej 100.000 € - 150.000 € prap është e pamjaftueshme me i mbuluar, e kam të qartë por nuk mundet të barten, e sa i përket se a mundet të krijohet një kod i ri, mundet të krijohet kodi i ri por në kodin 40817 ndërtimi i rrugëve në komunës e Rahovecit nëse do të ketë hapësirë aty i kemi 28.000.00 € edhe ato do të shfrytëzohen për shtruarjen e asaj rruge.

Feim Fetishi – Atë rrugë do ta shtrojmë me zhavorr, por për kubëza nuk kemi mjete financiare sivjet, por edhe sikur të kishim mundësi ti qesim këto 10.000 € prapë me këtë shumë nuk kishim mundur asgjë të bëjmë, por me zhavorr do ta shtrojmë.

Kryesuesi – Besoj se afrimi di mbetet i kënaqur dhe në vitin tjetër besoj se do shtrohet edhe me kubëza, e qesë në votim këtë pikë të rendit? Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar pika kjo pikë e rendit të ditës.

6. Formimin e komisionit për ndryshim dhe plotësim të statutit të komunës. Ne kemi komision e për ndryshimin dhe plotësimin e statutit dhe nëse pajtoheni me vazhdua me këtë përbërje, nëse jo atëherë kalojmë me propozimet e reja. Përbërja e komisionit është: Qazim Qeska nga PDK, Florida Krasniqi PDK, Arsim Kastrati LDK, Bahtjar Hoti LB dhe Gazmend Sharku nga shoqëria civile. Këto janë këto 5 emra, AAK nuk dëshiron të jetë pjesë e këtij komisioni.

Rasim Fazliu – Ne grupi i PDK-së pajtohem me përfaqësuesit tonë dhe nuk jemi për ndryshime.

Fatmir Iska – Ne grupi i AAK nuk dëshirojmë të jemi pjesë e këtij komisioni.

Kryesuesi – E qesë propozimin në votim kush është për 12, kundra 6, abstenim 1, ju faleminderit.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Bashkësisë Islame në Rahovec lidhur me Vendimin 01 NR. 242 të datës 30.01.2015. Siç e dini Kuvendi i komunës e ka marrë një vendim në mbledhjen e fundit lidhur me çështjen e kompensimit të shpenzimeve të varrimit për familjarët të cilëve i vdesin personat e afërt, dhe nuk është aprovuar propozimi kryetarit që shpenzimet e varrimit të shkojnë përmes Bashkësisë Islame. Ne e kemi një kërkesë të përfaqësuesve të BI të cilën ja kanë drejtuar Kuvendit dhe unë si kryesues e kam adresuar këtë për mbledhjen e sotme. Kërkesa ka të bëjë që të kthehet në rishqyrtim edhe një herë kërkesa e kryetarit dhe të shkohet përmes BI. Çështja tjetër është që komuna e ka problem që të bëjë pagesa individuale dhe kjo merr shumë kohë.

Kryetari – Në mbledhjen e kaluar unë kam dhanë një propozim, është diskutuar, është votuar dhe nuk ka kaluar. Tani kemi një kërkesë nga Bashkësia Islame dhe në kërkesë është e shënuar qartë se është lehtësim ma i madh edhe për personat të cilët do të jenë përfitues të asaj ndihme simbolike dhe njëkohësisht kemi biseduar edhe me drejtorin e financave se ka shumë probleme që janë të natyrës burokratike që do ta vështirësojnë realizimin e këtij projekti. Unë mendoj se propozimi që e kemi qitë në Kuvend mbledhjen e kaluar ka qenë ma i arsyeshëm se sa vendimi që është marrë, por prapë ju jeni ata që vendosni se a do ta miratoni kërkesën e bashkësisë islame apo jo.

Shani Sylka, përfaqësues i BI – Më lejoni të ju falënderojë për zemërsisht për mundësin që na e dhatë për të arsyetuar përpara jush kërkesën këshillit të bashkësisë islame në Rahovec për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit komunal të Rahovecit Nr 01 204, të datës 30.01.2015, për mbulimin e shpenzimeve të varrimit. Fillimisht ideja për shpenzimet e varrimit në marrëveshje me këshillat bashkësisë islame ka filluar të zbatohet në komunën e Mitrovicës dhe kjo metodë është treguar shumë e suksesshme dhe në interes të qytetarëve dhe gati gjysma e komunave të Kosovës kanë lidhur marrëveshje me këshillat e bashkësive islame përkatëse për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, prandaj edhe Këshilli i bashkësisë islame në Rahovec duke e parë nevojën dhe vështirësitë e qytetarëve që kanë me rastin e vdekjes e të afërmeve të tyre ka marrë vendim që në Bashkëpunim me komunën e Rahovecit të i ofrojë ndihmë qytetarëve në këto momente të vështira dhe ndihma më e madhe që mundet ti ofrohet qytetarëve në këto momente të vështira është marrja përsipër e punëve teknike që merren me varrimin siç janë hapja e varrit, dërrasat, qefinët, transporti si dhe gjërat tjera që lidhen me ceremoninë e varrimit. Gjithashtu mendojmë se realizimi i shpenzimeve të varrimit nëpërmjet Këshillit të BI mundëson barazinë sociale të qytetarëve, sepse si të pasurve ashtu edhe të varfërve do t'ju ofrohen shërbimet e njëjta pa kurrfarë dallimi Po ashtu edhe menaxhimi i shërbimeve të varrimit sipas kërkesës sonë është edhe në interes të komunës, ngase këshilli i BI merr përsipër evidentimin e të dhënave në librin AM të të vdekurve dhe dorëzimin e listës së të vdekurve në fund të çdo muaji, prandaj ne me të drejtë presim që kërkesën tonë me votën tuaj ta përkrahni fuqishëm.

Kryesuesi – Besoj se keni tani informacione të mjaftueshme për këtë pikë dhe i kisha lutë përfaqësuesit e BI që ta lirojnë sallën për shkak mos ndikimit të votimit sepse është konflikt interesi.

Rasim Fazliu – Ne në mbledhje e kaluar e kemi laburuar këtë temë dhe i kemi dhanë arsyetimet, tani vetëm se është ndërruar pronari i kërkesës, atëherë ka qenë Kryetari tash është BI. Pajtohem plotësisht që kjo kërkesë të mbështetet sepse me të vërtetë është interesi i qytetarëve të komunës së Rahovecit, dhe në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së e mbështesim këtë kërkesë.

Bahtjar Hoti - Unë mendoj se ne e kemi marrë një vendim të arsyeshëm dhe ai vendim ka dalë nga debatet e shumta dhe tash po bëhet një kërkesë që të kalojmë në jo arsye. Kjo kërkesë ma tepër shihet si interes i dikujt se sa ajo që është debatuar mbledhjen e kaluar. Nuk është mirë të shfuqizohet vendimi dhe të merret një vendim i ri, sepse ne në mbledhjen e kaluar ma së shumti kemi mbrojtur interesat e qytetarëve se sa interesat e hoxhallarëve.

Xhihad Vuçitërna – Është e vërtetë se në mbledhjen e kaluar është prurë një vendim si është prurë, unë mendoj se në mbledhjen e kaluar kërkesa nuk ka qenë e kompletuar sikur sot dhe sot kemi pas rastin të dëgjojmë edhe nga parashtruesi i kërkesës arsyen, nevojën se pse një marrëveshje e tillë duhet të lidhet mes komunës dhe BI. Mbi 90% kur kanë rast vdekje i kryejnë procedurat përmes BI. Siç e dimë BI në Rahovec mbijeton me donacione dhe mbështetje të popullit dhe unë mendoj se BI gjithë punën që e kryen e kryen në shërbim të popullit që jeton në këtë komunë. Këtu nuk ka përfitime personale as nga ana e hoxhallarëve as nga ana e dikujt tjetër. Ne të gjithë e dimë se kur dikush i afërm fatkeqësisht vdes ne të gjitha ato shërbime të varrimit i kërkojmë nga BI. Kjo marrëveshje e lehtëson këtë procedurë për qytetarin që të mos merret me procedurat e varrimit në ato ditë të vështira. Ftoj të gjithë deputetët e pranishëm që ta përkrahin këtë kërkesë dhe ta votojnë pozitivisht për shkak se drejtpërdrejtë ne do të përfitojmë.

Fatmir Iska – Ne në seancën e kaluar kemi marrë një vendim me shumicë votash dhe grupi i AAK i qëndron mbrapa atij vendimi, përderisa nuk rregullohet kjo çështje me një rregullore ose me Ligjin për bashkësitë fetare dhe nuk është paraqitë ndonjë situatë e jashtëzakonshme që të veprojmë ndryshe. Përpos asaj që kemi vendosë në mbledhjen e kaluar, ne kemi qenë kundër formës së rregullimit të kësaj çështje dhe assesi kundër BI e jo siç janë shpërndarë dezinformata kinse AAK është kundër kësaj marrëveshje të komunës me BI.

Selim Duraku – Unë edhe në mbledhjen e kaluar kam qenë pro kësaj kërkesë. Desha ti marr disa shembuj, në muajin e kaluar që ka ndodhur në fshatin Krush e Madhe ku ka shkuar përmes BI dhe gjithçka ka shkuar në rregull, ka qenë një ndihmesë e madhe për ata familjar që kanë pas rast vdekje sepse familjarët nuk kanë pasur nevojë të shqetësohen për asgjë. Unë flas edhe në emër të grupit të LDK, ne jemi pro kësaj kërkesë dhe e përkrahim me gjitha ato sqarime që i dha edhe imami.

Rexhep Oruçi – Unë e përkrahi plotësisht mendimin e Rasim Fazliut sepse është marrë ne emër të grupit të kuvendarëve të PDK dhe këtë pikërisht për dy arsye: e para është fakt që është marrë një vendim me 30 janar, por unë mendoj se nuk është bërë analiza e mirëfilltë e ofrimit të shërbimeve mortore rreth formës se si do të zhvillohet, realizohet në të ardhmen. E dyta nuk i kemi analizuar

fare se si do t'ju mundësohet qytetarëve të bëhet pagesa ajo formë teknike administrative dhe procedurale. Të dyja këto na tregojnë qartë se duhet të reagojmë dhe duhet ta gjejmë formën ma të mirë se si ti dalim në ndihmë qytetarëve në ditët fatkeqësie. Ky vendim duhet të modifikohet pak ma ndryshe dhe shërbimet e varrimit të shkojnë përmes BI, ndërsa modaliteti tjetër që këta kanë kërkuar në atë kërkesë ku kanë cekë që çdo qytetarë për çfarëdo arsye nuk e merr shërbimin nga BI në Rahovec, ta ketë mundësinë të kompensohet nga komuna e Rahovecit në mënyrë individuale. Ne duhet të obligojmë BI që asnjë qytetar të mos e anashkalojë dhe të gjithëve të kryejnë shërbimet. Nëse qytetari vullnetarisht kërkon shërbime ceremoniale me shëh ose me hoxhë është çështje e tij, por çështjen e varrimit duhet t'i ndajmë nga çështjet e shërbimit ceremonial. Ky është një vendim i përkohshëm i cili duhet në vitet e ardhshme të rregullohet në forma tjera dhe ndoshta këtë shërbim do ta ketë komuna me 3-4 punëtorë që do kryejnë këtë shërbim dhe ju kishim shmangë këtyre përçarjeve që i kemi në komunën tonë.

Bahtjar Hoti – Nuk qëndron ajo që u tha se nuk e kemi bërë analizë, pikërisht mbi bazat e një analize të mirëfilltë dhe debatit konstruktiv brenda kuvendarëve është nxjerr një vendim që ne jemi të vetëdijshëm që përfaqësohemi edhe nga komiteti katolik, çfarë diskriminimi jemi duke e bërë për komunitetin katolik. Shumë në rregull ka qenë kur kryetari e ka bërë këtë propozim dhe është miratuar vendimi i kryetarit të komunës që përfaqëson shumicën dërmuese të qytetarëve duke i përfshi edhe ata të komunitetit katolik, ne pikërisht jemi duke bërë përçarje me shfuqizimin e vendimit të parë, vendimi i parë askënd nuk e diskriminon.

Lulëzim Sylejmani – Sa i përket kompensimit për këtë rast nëse shkohet në mënyrë individuale është problem për realizim, sepse secili parashtrues i kërkesës duhet të regjistrohet në sistemin SEIMFK në thesar dhe atje do të duhet një mori dokumentesh dhe neve në komunë në Drejtorin e financave. Na duhet një njeri i veçantë që ta kryej këtë punë dhe nuk e di a kish pas mundësi me mbërri me e krye në mënyrë individuale. Gjatë gjithë vitit ne në sistemi SEIMFK mund të regjistrojmë 70-80 operatorë në sistem ndërsa një mesatare sipas informacioneve që i kamë diku rreth 250-280 persona është vdekshmëria në komunën tonë.

Ejup Kabashi – Unë e përkrahi këtë formë dhe të kalojë ky propozim falë edhe sqarimeve, sepse unë pikërisht procedurën e pagesave e kam ngritë si shqetësim në mbledhjen e kaluar, dhe unë propozoj që ky vendim të aprovohet.

Qazim Qeska – Në mbledhjen e kaluar unë për veti e di se si kam votuar por sidoqoftë kërkesën për rishqyrtim e keni marrë të arsyeshme dhe ne e kemi diskutuar në grupin parlamentar ku jam pajtuar me kolegët e mi, por ky arsyetimi i juaj më shton bindjen ma shumë, për arsye se unë në një pjesë të kërkesës së BI kam pas vërejtje, sidomos aty ku ceket të tjerët ku nuk dëshirojnë, ajo më ka penguar sepse unë nuk e di kush është ai i cili nuk dëshiron ti merr shërbimet e BI e që i takon konfesionit Islam. Por, besoj se kryetari me rastin e lidhjes së marrëveshjes do të ketë biseda edhe me përfaqësuesit e BI lidhur me respektimin e traditave përkatësisht praktikave në komunën e Rahovecit në përgjithësi e në Rahovec në veçanti, shumë mirë është të aprovohet propozimi bazë i kryetarit të komunës para aprovimit të këtij vendimi.

Kryetari – Për mu personalisht ajo që ka ndodhë me 30.01.2015 ajo çështje është përmbyll, tash ka ardhë një kërkesë të cilën po e shqyrtojmë sot dhe në bazë kësaj kërke po shqyrtohet vendimi i Kuvendit. Ju sot vendosni se a do ta ndryshoni vendimin dhe a do të më autorizoni mua që të bëjë marrëveshjen në detaje me BI duke mos i përjashtuar edhe bashkësitë tjera me secilën veç e veç. Po çka nëse ka individë prej gjitha bashkësive që thotë që unë nuk i dua shërbimet e bashkësisë së caktuar që i përket, e unë mendoj që komuna edhe atij duhet t'ja kompensojë atë vlerë simbolike, por individualisht unë nuk do ti përjashtoj as ata, ky është mendimi dhe qëndrimi im..

Bahtjar Hoti – Sa i përket këtij vendimi unë mendoj se jemi duke bërë mirë që pe shqyrtojmë por atë që e tha kryetari që nuk munden të anashkalohen edhe komunitetet tjera duhet ta keni parasysh këtë punë, ne jemi institucion që nuk i takojmë asnjë bashkësi fetare në këtë rast edhe ne duhet ta ushtrojmë drejtë funksionin që jemi të ngarkuar.

Kryesuesi – E qesë në votim ndryshohet apo refuzohet vendimi i Kuvendit me Nr. 01-242 të datës 30.01.2015 dhe fuqizohet propozimi Vendimi i kryetarit të komunës të cilin e kemi refuzuar në mbledhjen e kaluar, e qesë në votim? Për 14, kundra 8, abstenime 1.

8. Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për subvencionim.

Osman Hasku – Drejtoria për rini, kulturë, dhe sport me datën 03.02.2015 ka shpallur konkurs për të gjitha llojet e aktiviteteve të cilat janë në kuadër të rregullores për subvencionimin Nr 1830 të datës 30.04.2013. Kanë konkurruar 21 OJQ në shuma monetare gjithsej 85.000 €, prandaj në dispozicion të subvencionimeve të Drejtorisë për KRS janë gjithsej 30.000 €. Kërkoj nga ju që në bazë të kësaj Rregullore pika 6.4 ju obligon juve si kuvend që të na jepni pëlqimin për shumat mbi 2.000 € për OJQ apo për shumat mbi 500 € për individ të caktuar për projekt propozimet e ndryshme. Po ashtu kërkojmë nga ju që të na jepni pëlqimin për subvencionimin e 3 ekipeve e ato janë KF Rahoveci, KF 18 Korriku dhe SHKA Bajram Curri Krushë e Madhe. Propozimet tona janë që këto të subvencionohen KF Rahoveci me 10.000 €, KF 18 korriku me 4.000€ dhe SHKA Bajram Curri me 4.000 €.

Xhihad Vuçitërna – Unë nuk e pashë këtu kërkesën e KB Rahoveci në materialin që e kemi marr dhe unë e pyes drejtorin cila është mundësia që edhe KB Rahoveci të subvencionohet me një shumë, pasi siç e dimë KB garon në ligën e parë dhe po kor një rezultate goxha të mira dhe ka arit një sukses shumë të mirë për një periudhë shumë të shkurtë ndërsa po ballafaqohet me vështirësitë financiare. Prandaj kërkoj nga drejtori që të gjejmë një farë mundësie që në këtë program të subvencionimit të inkuadrohet edhe KB Rahoveci.

Selim Duraku – Unë e përkrahi kërkesën për KF Rahoveci, KF 18 Korriku dhe SHKA Bajram Currin, dhe unë kisha me propozuar që të votohen këto 3 propozime me këto shuma si janë, dhe propozoj që ato mjete që mbesin të ndahen për këto klube tjera si që i kemi KB Rahoveci dhe klubet e tjera.

Beatrisa Demiri – Unë mendoj se KF Rahoveci me 10.000 € nuk do ketë reprezentacion të mirë dhe propozoj që të subvencionohet edhe me 5.000 € tjera.

Kadri Dellova – Së pari e përkrahi propozimin e Beatrisës fuqishëm sepse vet kam qenë kryetar klubi dhe trajner e po ashtu edhe futbollist dhe i di vështirësitë që i kemi pas. Për fat të mirë KF Rahoveci është në ligën e parë dhe padyshim është ekipi më i mirë në këtë ligë dhe jam fuqishëm që të përkrahet KF Rahoveci dhe propozoj ti ritet në 15.000 €, SHKA Bajram Curri në 5.000 € sepse këtë vit e ka 410 vjetorin e themelimit dhe është shoqëria ma e dalluar jo vetëm në komunë por në regjion të Kosovës. Kjo shoqëri

çdo manifestim që organizohet në komunë është prezentë dhe programin që ofron është i pranueshëm dhe shumë i pëlqyer nga të gjithë. Unë kam një kërkesë nga kryesia e fshatit e Krushës së Madhe për Zana Selami Hoti, është vajza e selami Hotit, është aktiviste i fshatit dhe është vajza që në familje i ka 3 familjarë të vvarë, 2 dëshmorë, është një familje që dem baba dem i ka dhënë kombit. Pra është një familje patriotike dhe prindin e ka të papunë. Kjo vajzë e ka kryer një operacion me sukses me ndihmën që i kanë dhënë qytetarët e Krushës dhe njerëzit vullnet të mirë dhe këto ditë do të shkojë që ta kryej edhe një operacion shumë delikat dhe të rëndë jashtë shtetit sepse është në pyetje jeta e një fëmije ku shpenzimet kalojnë 30.000 €, prandaj propozoj që ky Kuvend të aprovtoj kërkesën e kësaj familje në vlerë 5.000 €.

Kryesuesi – Unë kam respekt për gjithë sidomos ata që e kanë gjendjen shëndetësore të rëndë, por duhet të dini që ne jemi në muajin e 2 ndërsa mund të vinë edhe shumë raste të njëjta. Duhet të jemi pro por me mundësi, e jo dikujt ti japim sa të mundemi e dikë tjetër ta lëmë të vdesë, mundë të kemi raste edhe më të rënda. Kam biseduar me Kryetarin dhe mundësitë janë deri 3.000 €. Ne këtu i kemi 21 kërkesa ndërsa 30.000 € i kemi në dispozicion, po ashtu kemi edhe një kërkesë të cilën nuk e kemi prezantuar, është shkolla e futbollit Rahoveri.

Osman Hasku – Nëse më lejohet do ju kisha lexuar të gjitha aplikimet? Qendra rinore Buzë Drini ka aplikuar me 4 aplikacione, njëri është 235 €, 495 €, 276 €, 228 €, Shoqëria artistike Anadrini për incizim në studio ka aplikuar me 1,056.50 €, Art Studio me 5.000 € në Drejtorin për KRS, ndërsa pjesën tjetër të subvencioneve do ta sigurojë nga donatorët e tjerë, Instituti për ngritjen e kapaciteteve rinore Siguria e të rinjve është titulli me 2.920 €, Këshilli rinor i Rahovecit, Manifestimet rinore për mbrojtjen e mjedisit 4.320 €, Rinia multietnike regionit të Prizrenit, fuqizimi i të rinjve të komunitetit pakicë në komunën e Rahovecit me 2.910 €, Shkolla e basketbollit Rahoveci me 450 €, KB Rahoveci me 2.850 €, Mbrojtja e popullatës nga ndikimet në mjedis të rinjtë Arti dhe rekreacioni me 1.900 €, Naser Dula - Shkolla për kitarë për shkollat e muzikës me 2.500 €, Qendra rinore Rahovec, Teatri rinor vlera e qytetit tonë 1.980 €, SHKA Rahoveci gardërobë e tjera me 3.240 €, Klubi shahut i Rahovecit me 6.400 €, KF Rahoveci zhvillimi i garave në kampionat me 5.270 €, Qendra për zhvillim dhe bashkëpunim lokal LDCC Art urban rural me 2.669,50 € dhe këto tri kërkesa KF Rahoveci me 23.000 €, KF 18 Korriku me 4.000 € dhe SHKA Bajram Curri me 13.000 €, Dua t'ju bëjë me dije se ekzistojnë edhe 3 kode buxhetore prej të cilit përfituesi më i madh çdo herë ka qenë KF Rahoveci dhe 18 Korriku, sidomos për udhëtimin e tyre. Investimi në Kulturë, investimi në Sport dhe investimi në Rini, në investim për sport janë 10.000 €, dhe në kohën e fundit KF Rahoveci, KF 18 korriku dhe KB Rahoveci nuk janë duke hequr për udhëtim, udhëtimin e kanë të siguruar nga komuna, kodi mbështetje për rini prej 5.000 € dhe kodi për mbështetje për kulturë 6.185 €. Nga ju kërkojmë që të na lejoni subvencionimin e së paku këtyre 2 klubeve sepse kampionati do të fillojë. Me rishikimin e buxhetit është të rriten edhe subvencionet nga mallrat dhe shërbimet nëse arrijmë ti kursejmë si i kemi kursyer deri tani, por nuk do të thotë që në ditën në vijim nëse ka ndonjë arsye për ta subvencionuar dike në shumë ma të madhe se 2.000 € nuk do ta parashtrijmë kërkesën.

Kryesuesi – Ne sot do të marrim vendim vetëm për kërkesat që janë mbi 2.000 € ato që janë më pak se 2.000 € kryetari ka drejtë pa Kuvend ti jap ne i kemi tre kërkesa që i ka propozuar drejtori ti ndahen ato që u përmendën ma lartë.

Nënkryetari – Përsëritet për të gjithë, edhe në KPF kemi pas një debat të vogël lidhur me këto gjëra, mirëpo sot pe e ndiej vetën pak të mangët dhe nuk po kuptoj gjërat se pse jemi në këtu dhe për çka kërkohet pushteti në përgjithësi dhe për çka emërohet një drejtor i një drejtorie të caktuar. Keni një Rregullore për subvencione po të lexoni qartë atë rregullore nuk do të flitje drejtori kështu por do të citoje në mënyrë të qartë se çka duhet të bëjë dhe pse është nxjerrë ajo rregullore Në Rregullore shkruan qartë si subvencionohen të gjitha ato aktivitete sportive të cilët japin rezultate kulminante. Këtu e kemi KB për herë të parë në histori të rrafshit të Anadrinisë që pretendon të shkojë në super ligën e Kosovës. Deri me sot nuk kanë kërkuar asnjë cent, nga vullneti drejtori nëpërmjet kryetarit i ka dhanë 1.200 €

Kryesuesi – Është dashur kjo çështje të parashihet nënkryetar kur është përpiluar buxheti sepse tash janë vetëm 30.000 € ku do ti ndajmë më parë sepse ka shumë kërkesa.

Lulzim Sylejmani – Sa i përket pjesës së mbështetjes së rinisë, kulturës dhe sportit përveç subvencioneve janë edhe 3 kode të tjera dhe drejtori besoj se e dinë sa është vlera dhe ju i keni aprovuar në Kuvend sepse ato janë si projekte janë nga kapitalet, nga të hyrat vetanake dhe një pjesë e tyre mund të përdoret për mbështetje të atyre 3 sektorëve. Çdo klub që përfiton nga Kuvendi shumë prej 2000 € duhet të vijë dhe të jep raport mbi shpenzimin e atyre mjeteve, 14.000 € vitin e kaluar që ka përfituar KF Rahoveci dhe disa OJQ tjera që kanë përfituar nga 2.000 € ata raport nuk kanë sjell dhe ne kemi marrë vërejtje në raportin e auditimit.

Fatmir Iska – Ne e kemi diskutuar edhe në KPF por tani janë shtuar edhe disa kërkesa tjera. Vitin e kaluar afër 15.000 € është subvencionuar KF Rahoveci ndërsa tani i kemi 10.000 € që do të thotë është zvogëluar ajo shumë. Ne kemi mbështetur propozimin e Beatrisës që të shtohet edhe një shumë prej 5.000 € për KF Rahoveci. Klubi mund të ketë të hyra nga biletat që sipas informatave mund të jenë 1.500 € deri në 2.000 € në sezon. KB Rahoveci është riaktivizuar vitin e kaluar dhe është duke ecur mirë dhe po korr suksese në fitoret, pra nuk duhet lënë anash, por edhe klube të tjera që dëshirojnë të riaktivizohen. Ne jemi që këto klube ta vazhdojnë punën e vet me propozimet shtesë që janë dhënë, në mënyrë që të promovohen edhe ne për kulturë.

Kadri Dellova – Unë e përkrahi mendimin e kryetarit që me të vërtetë të subvencionohen OJQ – te ose shoqatat që kanë vlera qoftë sportive qoftë kulturore. I propozoj drejtorit që ata shoqatat që nuk kanë vlerë mos të përkrahën si për shembull projekti i Egzodit i ka marrë 1.450 € çka na vyen neve asi projekte më mirë ato mjete ti marrin klubet e komunës së Rahovecit ose SHKA se sa një Egzod ose jo të përkrahën projektet që përfitojnë individët.

Qazim Qeska – Kryesues sipas rregullores ju jeni sovran i saj për të respektuar dhe ju për secilën pikë e keni për detyrë që të jepni rekomandimin e KPF. Në këtë rast ne këtu nuk kemi as propozim vendim, ne jemi duke u marrë me kërkesa. Kuvendi nuk merret me kërkesa, po ti kishim pas këtu propozimet e KPF në të cilët marrin pjesë edhe drejtorët e resorëve përkatëse dhe drejtori i financave që menaxhon atë resor, atëherë deri tash ne kishim vendosur shumë çështje. Ne tani jemi duke trajtuar kërkesat dhe nuk kemi asnjë propozim vendim për të cilin do të deklarohejmë po ose jo, drejtori e tha këtë shumë qartë ju mund të merrni çfarëdo vendimi ne nuk do e respektojmë.

Bahtjar Hoti – Duke pasur parasysh rrinë që e kemi aktive gjitha nismat rinore janë me vend, por mundësitë buxhetore nuk i kemi. Kishte me qenë mirë të bëhet një listë prioritare duke u nisur nga KF Rahoveci, SHKA Bajram Curi Krushë e Madhe, Anadria Jehon, sepse me të vërtetë e ka bërë një jehonë të madhe dhe sipas mundësive buxhetore t'i subvencionojmë.

Kryesuesi – Unë nuk e di se pse kaq shumë jemi duke debatuar, kemi vetëm 30.000 € dhe 18.000 € janë të propozuar nga kryetari dhe kanë mbetur vetëm 12.000 € dhe ato mundet t'i shpërndaj kryetari për ato OJQ që kanë kërkesa më pak se 2.000 €, po nëse doni ne po i harxhojmë të gjitha dhe kryetari mos të ketë mundësi t'i ndihmoj askujt.

Rasim Fazliu – Ne të gjithë jemi që ti ndihmohet rinisë në të gjitha disiplinat sportive, mirëpo nuk kemi mundësi buxhetore sepse 30.000 € janë nuk ka ma shumë. Në KPF drejtori na ka paraqitë këto 3 kërkesa dhe ne i kemi shqyrtuar dhe i kemi lanë punën e hapur, kemi thanë nëse ka mundësi kryetari t'i ngritë këto shuma si kemi propozuar ne në KPF dhe ai të na jep një shpjegim se a mundet dhe ne në Kuvend do ti miratojmë, mirëpo sa po shoh kryetari nuk paska lëvizur në këto pika. Ne mundemi edhe këtu të propozojmë por po frikohem se këta nuk munden të i mbulojnë me mjete materiale.

Osman Hasku – Vetëm dua të ju premtoj që kurrfarë tendence nuk ka pasur, tendenca e vetme sipas fjalës së nënkryetarit se paskam qenë tendencioz, ka qenë që të gjithë të përfitojnë dikush ma shumë dikush ma pak, por të gjithë të jenë fitues. Në anën tjetër unë propozimin e Xhihadi e përkrahi sepse ata janë duke dalë në super ligë - KB.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e Betrisës që KF Rahoveci t'i shtohen edhe 5.000 € dhe të shkoj me 15.000 €: Në mënyrë unanime është aprovuar. Shkojmë me propozimin e Kadrisë që SHKA Bajram Curri t'i shtohet edhe 1.000 € dhe të subvencionohet me shumën 5.000 € po ashtu edhe kjo në mënyrë unanime është aprovuar Kalojmë tek KB Rahoveci 2.500 € edhe kjo në mënyrë unanime është aprovuar, e kemi edhe kërkesën për shëndetësi kryetari ka mundësi 3.000 € me i nda por nëse ka mundësi drejtori me i nda pak më shumë letë të na tregon.

Munib Durguti – Drejtoria e ka një buxhet për subvencione dhe gjatë tërë vitit diku afër 40.000 €. Në 2 muaj të parë kemi pasur 73 kërkesa dhe shumica prej tyre kanë pasur një arsyeshmëri shumë të madhe që duhet ndihmohen dhe 61 prej tyre i kemi aprovuar dhe vetëm 12 kërkesa i kemi refuzuar. Në rastë që komisioni i cilëson si tejet në nevojë dhe ato janë rastë që lëngojnë nga sëmundja e kancerit dhe maksimumi që kemi shkuar ka qenë 120 € për një rast, gjithmonë mbi bazën që me këtë buxhet të shkojmë deri në fund të vitit. Nëse për këtë rast propozimi i kryetarit është për 3.000 € ne nuk jemi kundër, unë pres prej juve që të jeni më racional sepse nevoja është shumë e madhe dhe të keni parasysh kur votoni edhe mundësit buxhetore që i ka kjo Drejtoria.

Luljeta Kadiri – I falënderohem drejtorit për arsyeshmërinë e deficitit të buxhetit dhe për përkrahje të kërkesave të shumta dhe jam e vetishme se sa nevoja dhe kërkesa ka populli, mirëpo rasti i vajzës së Selami Hotit kërkon një angazhim pak më të madh dhe unë e mbështes kërkesën jo me 3.000 € por propozimi imë është 5.000 €.

Fatmir Iska – Ne e përkrahim propozimin prej 5.000 € dhe ti ndihmohet kësaj fëmije sepse shuma prej 3.000 € është e paktë për deri sa prindi i fëmijës ka paraqitë shpenzimet se sa mundë t'i kushtojnë ato operacione.

Rasim Fazliu - Edhe ne mendojmë se është mirë t'i dilet në ndihmë dikujt, e kuptojmë edhe buxhetin që është i vogël por edhe ne jemi që t'i ndahet 5.000 € për shërimin e kësaj vajze.

Kryesuesi – E qesë në votim kush është për propozimin që 5.000 € t'i ndahet kësaj vajze: në mënyrë unanime është aprovuar që t'i ndahen 5.000 € kësaj vajze për shërim.

9. Ndryshimi dhe plotësimi i anëtarëve të komiteteve. Në Komiteti për shërbime publike komunale ka qenë Marigona Berisha është tërhequr dhe duhet të zëvendësohet me një anëtar nga LDK.

Selim Duraku – Për këtë komitet e propozojmë Arsim Kastratin.

Kryesuesi – E qesë në votim kush është për Arsim Kastratin: Në mënyrë unanime është aprovuar propozimi për Arsim Kastratin për këtë komitet. Kemi Komisionin për bursa, edhe këtu ka qenë Marigona dhe duhet të zëvendësohet me një tjetër anëtar nga LDK.


Selim Duraku – Për këtë komision e propozojmë Luljete Kadiri.

Kryesuesi – E qes në votim kush është për Luljete Kadiri për këtë komision: është aprovuar në mënyrë unanime për anëtare të komisionit për bursa. Kemi komisionin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër kemi pas një kërkesë nga AAK që të jenë pjesë e këtij komisioni dhe kanë propozuar që të jetë z., **Florije Boshnjaku**, pra në vend të Bahtjar Hotit. Po ashtu Etem Haxhimustafa është tërheq nga shoqëria civile dhe unë kisha me propozuar që nga shoqëria civile të jetë nga **KDI-ja**. Kush është për këto propozime: me një abstenim dhe të tjerët pro janë aprovuar emrat e propozuar.

10. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e delegatëve. Pyetjet mund t'i bëni me shkrim. Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 16.40.

Procesmbajtësi,
Fahredin Sharku



Kryesuesi
Nahit Elshani